



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

Nr. i Dokumentit: 21x;22x.9-2014/16-08

**RAPORTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**  
**“MENAXHIMI I MARRËVESHJEVE TË BASHKËFINANCIMIT ME**  
**DONATORËT DHE REZULTATET E ARRITURA”**

Prishtinë, shkurt 2018

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërdrejt llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për të kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime të pavarura, objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë<sup>1</sup>, efikasitetit<sup>2</sup> dhe efektivitetit<sup>3</sup> dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me këtë raport “Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëfinancimit dhe rezultatet e arritura” në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme Vlora Mehmeti, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që e ka realizuar këtë raport:

Myrvete Gashi, Drejtorë i Auditimit

Vlora Duraku, Udhëheqëse e ekipit

Ylfete Osmani, Anëtare e ekipit

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT –Adresa: Musine Kokollari, Nr. 87, Prishtinë 10000, Kosovë

Tel.: +381(0) 38 60 60 04/1002/1012-FAX: +381(0) 38 2535 122 /219

<http://zka-rks.org/>

---

<sup>1</sup> Ekonomia –Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së resurseve. Resurset e përdorura duhet të jenë në dispozicion me kohë, në sasi dhe cilësi të duhur dhe me çmimin më të mirë

<sup>2</sup> Efikasiteti – Parimi i efikasitetit nënkupton të marrësh maksimumin nga resurset në dispozicion. ka të bëjë me lidhshmërinë ndërmjet resurseve të angazhuara dhe rezultateve të dhëna në kuptim të sasisë, cilësisë dhe kohës

<sup>3</sup> Efektiviteti – Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritura.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje.....	6
1 Hyrje.....	9
2 Përshkrimi i sistemit për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëfinancimit me donatorët. 15	
2.1 Lidhja e marrëveshjeve me donatorët në nivelin qendror Qeveri-Qeveri .....	15
2.2 Lidhja e marrëveshjeve në nivelin lokal Komunë-Donatorë.....	16
3 Gjetjet e auditimit .....	17
3.1 Menaxhimi i informacionit për bashkëfinancimet me donatorët.....	17
3.2 Koordinimi i MIE me institucionet tjera për marrëveshjet e bashkëfinancimit .....	18
3.3 Roli i MIE për funksionimin e grupeve punuese për përcaktimin e prioritetëve.....	19
3.3.1 Sistemi i integruar i koordinimit të monitorimit, vlerësimit dhe raportimit të financimeve Qeveri-Donatorë dhe zotimet e tyre .....	21
3.3.2 Raportimi dhe Llogaridhënia .....	21
3.4 Realizimi i projekteve dhe zotimet qeveritare për marrëveshjet e bashkëfinancimit .....	24
3.4.1 Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, punësimi dhe rritja e mirëqenies së qytetarëve	24
3.4.2 Arsimi, shkenca, kultura, sporti dhe zhvillimi rinor.....	34
3.4.3 Shëndetësia moderne.....	37
4 Konkluzionet.....	43
5 Rekomandimet.....	46
Shtojca 1. Të ardhurat e Qeverisë dhe të ndihmës së huaj.....	48
Shtojca 2. Të ardhurat nga donatorët për vitin 2016.....	49
Shtojca 3. Niveli qendror-projektet me bashkëfinancim nga donatorët .....	50
Shtojca 4. Niveli lokal-projektet me bashkëfinancim nga donatorët.....	51

---

## Lista e shkurtesave

AAP	Aftësimi i Arsimit Profesional
BE	Bashkimi Evropian
BD	Bordi Drejtues
CDI	Community Development Initiatives
DAZH	Departamenti i Asistencës Zhvillimore
DIEKP	Departamenti për Integritim Evropian dhe Koordinim të Politikave
FNL	Forumi i Nivelit të Lartë
GNB	Gratë në Biznes
GPS	Grupet Punuese Sektoriale
GPNS	Grupet Punuese Nënsektoriale
IHD	Investimet e Huaja Direkte
KD	Komiteti Drejtues
KRU	Kopmania Rajonale e Ujrave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MIE	Ministria e Integritimeve Evropiane
MF	Ministria e Financave
MM	Marrëveshje Memorandumi
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NP	Ndërmarrje Publike

---

OE	Operator Ekonomik
OB	Organizata buxhetore
PMN	Platforma për menaxhimin e ndihmës
QR	Qendrat Rajonale
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
RAE	Komuniteti Rom Ashkali Egjiptianë
RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
UA	Udhëzim Administrativ
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

## Përmbledhje

Duke pasur parasysh fondet e kufizuara të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkrahjet financiare nga jashtë mbeten një burim i rëndësishëm për realizimin e prioriteteve zhvillimore të Programit të Qeverisë në Kosovë.

Qeveria, përmes Ministrisë së Integritimit Evropian si përfaqësuese e saj, duhet të zbatoj një sistem të mirëfillt për planifikimin, koordinimin dhe menaxhimin e ndihmës së jashtme. Ministria e Integritimit Evropian në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha ministritë duhet të shqyrtojë se përtë gjitha projekt propozimet për financim, të bëhet një vlerësim paraprak nëse këto projekte janë në përputhshmëri me prioritetet qeveritare apo edhe evitimit të dyfishimit me fonde të donatorëve të tjerë.

Menaxhimi dhe organizimi i ndihmës së jashtme mbështetet në parimet e Deklaratës së Parisit, Agjendën "Accra" e cila praktikisht është një udhërrëfyes për tu orientuar aktivisht në përmirësimin e kualitetit të asistencës dhe ndikimin e saj në zhvillim.

Auditimet e rregullsisë të kryera në vitet e mëparshme nga Zyra Kombëtare e Auditimit kanë theksuar se procesi i bashkëfinancimeve me donatorët nuk është menaxhuar si duhet dhe ka nevojë për përmirësim.

Duke ditur rëndësinë e përkrahjeve nga jashtë në përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike për qytetarët, Zyra Kombëtare e Auditimit është motivuar të kryejë auditimin e performancës "Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëfinancimit dhe rezultatet e arritura". Subjekt i auditimit është Ministria e Integritimit Evropian, përkatësisht Departamenti i Asistencës Zhvillimore, Ministria e Financave në aspektin e vlerësimit të ndikimit buxhetor, si dhe organizatat në cilësinë e përfituesve si: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, si pronare e Ndërmarrjeve Publike, KRU "Hidromorava" në Gjiilan dhe KRU "Hidroregjioni jugor" në Prizren si dhe nivelin komunal: Komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës, Gjakovës si dhe Komunën e Prizrenit.

Ky auditim ka mbuluar marrëveshjet e bashkëfinancimit me donatorët e jashtëm për periudhën 2014-2016.

---

## Konkluzione

Qeveria e Kosovës nuk ka arritur të instalojë mekanizma të qëndrueshëm të cilët do të ndihmonin në koordinimin, monitorimin dhe raportimin e bashkëfinancimeve. Qasja dhe gjurmueshmëria e informatave të qeverisë për bashkëfinancimet deri tek përfituesi i fundit është mjaftë e vështirë. Marrëveshjet e ratifikuara shpallen në gazetën zyrtare mirëpo qeveria nuk ka deleguar përgjegjësin tek asnjë institucion i cili do të mirëmbante informacionin se sa është vlera financiare e ndihmës së jashtme, sa është financimi nga institucionet e Kosovës, cili sektorë është financuar si dhe cili është progresi i realizimit të bashkëfinancimeve. Mungesa e informatave të plota lidhur me bashkëfinancimet ndikon në vendimmarrje jo të drejtë, rritë rrezikun për dyfishimin e financimit në sektorë njëjtë si dhe zbehë llogaridhënien dhe transparencën.

Ministria e Integrimeve Evropiane si përgjegjëse për koordinimin e ndihmës së jashtme në nivel të Republikës së Kosovës nuk ka arritur të koordinoj, monitorojë dhe raportojë përfshirë këtu edhe të prezantoj prioritetet e qeverisë para donatorëve të jashtëm. Auditimi ynë ka nxjerrë në pah që mekanizmat e vendosur nga Ministria e Integrimeve Evropiane nuk janë plotësisht efektiv për të siguruar mbarëvajtjen e proceseve që nga planifikimi, koordinimi për financimin e projekteve, si dhe realizimin dhe monitorimin e tyre.

Ministritë, Komunitat dhe Ndërmarrjet Publike si përfitues dhe implementues të projekteve nuk kanë arritur të realizojnë projektet në nivel të kënaqshëm drejt qëllimit për çka janë dhënë fondet. Nga tetë (8) projektet e audituara tri (3) janë realizuar plotësisht edhe përkundër disa vonesave dhe tri projektet tjera ende janë në proces e sipër dhe nuk janë duke u realizuar sipas afateve të parapara. Përderisa, dy projektet tjera janë realizuar brenda afateve kohore, mirëpo Komuna e Prizrenit nuk ka arrit të promovojë qendrën rekreative dhe si pasojë ajo nuk është e shfrytëzueshme nga qytetarët. Ndërsa, sa i përket Komunitës së Fushë Kosovës lidhja e marrëveshjeve për bashkëfinancim për vite me radhë përveç se nuk ishte në përputhje me objektivat e programit, nuk kanë bërë planifikimin e buxhetit për implementimin e projektit si dhe kanë bërë bartjen e mjeteve tek donatori.

## Rekomandimet kryesore

Qeveria e Kosovës duhet të siguroj se ka instaluar mekanizma të qëndrueshëm për menaxhimin e bashkëfinancimeve me theks të vecantë të siguroj se ka deleguar përgjegjësinë tek ndonjë institucion i cili mirëmban informacionin për bashkëfinancimet. Kjo do të ndikonte në vendimmarrje të drejtë dhe do të ruante kredibilitetin ndaj donatorëve.

Ministria e Integrimeve Evropiane si autoritet kyç mbi koordinimin e aktiviteteve të donatorëve dhe ministrive si përfitues të këtyre donacioneve, duhet të krijoj një sistem të mirëfillt për të siguruar që fondet nga donatori janë në harmoni të plotë me prioritetet zhvillimore si dhe janë të ndërlidhura sa më shumë që është e mundur me dokumentet strategjike në mënyrë që të arrihet efektivitet më i lartë.

Për ta bërë asistencën më efektive, në këtë proces duhet të zbatohen parimet e Deklaratës së Parisit (2005) e cila është e orientuar për të përmirësuar kualitetin e asistencës dhe ndikimin e saj në zhvillim. Ajo ofron një seri matjesh specifike të implementimit dhe vë bazat e një sistemi të

monitorimit për të vlerësuar progresin dhe për të siguruar se donatorët / përfituesit mbajnë njëri-tjetrin llogaridhënës për zotimet e tyre.

### **Përgjigjja e palëve të përfshira në auditim**

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Integritimit Evropian, Ministria e Arsimit, Ministria e Financave, Komuna e Fushë Kosovës, Komuna e Prizrenit, NP-të "Hidroregjioni Jugor" dhe "Hidromorava" janë pajtuar me të gjeturat dhe rekomandimet e auditimit. Ndërsa nuk kemi pranuar përgjigje nga: Sekretariati i Kuvendit të Kosovës, Komuna e Prishtinës dhe Komuna e Gjakovës. Inkurajojmë institucionet e përfshira në këtë auditim që t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar rekomandimet e dhëna.



---

# 1 Hyrje

Përkrahjet nga jashtë janë bazë për zhvillimin ekonomik për të gjitha shtetet, e në veçanti për shtetet në tranzicion siç është Kosova. Ato janë tregues i rëndësishëm i flukseve të kapitalit dhe zhvillimit të ekonomisë. Për një qeverisje më të mirë të fondeve publike dhe ato të huaja, Qeveria duhet të zbatoj një sistem të revitalizuar për planifikimin dhe menaxhimin e fondeve. Është esenciale që procesi i planifikimit dhe prioritizimi i projekteve të financuara nga donatorët të riorganizohet në përputhshmëri me nevojat e zhvillimit ekonomik shtetërorë.

Synim parësor i Qeverisë së Kosovës është ndërtimi i një qeverisje efektive, kompetente dhe të përgjegjshme, që do të forcojë jo vetëm besimin e qytetarëve mirëpo edhe të partnerëve ndërkombëtarë.

Qeveria e Kosovës ka miratuar Programin e Qeverisë 2015-2018, duke parashtruar prioritetet kyçe të vendit në pesë fushat në vijim:

- I. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, punësimi dhe mirëqenia;
- II. Sundimi i ligjit dhe shteti ligjor;
- III. Agjenda evropiane dhe politika e jashtme;
- IV. Arsimi, shkenca, kultura, sporti dhe zhvillimi rinor; dhe
- V. Shëndetësia moderne.

Qeveria përmes ministrive koordinon të gjitha aktivitetet e donatorëve në nivel sektorial dhe nën-sektorial, duke siguruar që këto fonde të jenë në harmoni të plotë me prioritetet zhvillimore si dhe të jenë të ndërlidhura sa më shumë që është e mundur me dokumentet strategjike në mënyrë që të arrihet efektivitet më i lartë.

Përkrahja e jashtme në Kosovë është realizuar përmes disa formave të bashkëpunimit. Njëra nga format më të rëndësishme për realizimin e projekteve zhvillimore është lidhja e marrëveshjeve bashkëfinancuese me donatorët e jashtëm.

Ajo që i bënë të rëndësishme marrëveshjet bashkëfinancuese, janë modalitetet e ndryshme të cilat mund të përdoren përmes lidhjes së kontratave, e të cilat reflektojnë ndarjen e veçantë të rrezikut dhe përgjegjësisë.

Sipas hulumtimeve dhe analizave tona, marrëveshjet më të rëndësishme në këtë kontekst janë marrëveshjet Qeveri-Qeveri dhe marrëveshjet Komunë -Donatorë.

**Marrëveshje ndërkombëtare Qeveri-Qeveri** – këto marrëveshje janë traktat i lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve të huaja ose organizatave ndërkombëtare në formë të shkruar,

---

e rregulluar me të drejtën ndërkombëtare pavarësisht nga emërtimi dhe nga përfshirja në një, dy apo më shumë instrumente të ndërlidhura<sup>4</sup>

**Marrëveshjet ndërinstitucionale Komunë-Donator** këto marrëveshje janë memorandume të lidhura në bazë të kompetencave të komunave me institucionet dhe organizatat përkatëse të shteteve të huaja. Këto marrëveshje nuk lidhen në emër të shtetit dhe Qeverisë së Kosovës dhe nuk ratifikohen.

Të drejtën e nismës për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare e kanë organet shtetërore të Kosovës në përputhje me Kushtetutën e vendit dhe ligjet në fuqi.

Nismat për marrëveshjet ndërkombëtare që vijnë nga ministrinë miratohen në parim nga Qeveria, kalojnë nëpër procedura të veçanta administrative si nga faza e inicimit, ekzekutimit, monitorimit dhe implementimit të tyre.

## Problemi i auditimit

Si indikatorë për të identifikuar problemet fillimisht jemi mbështetur në Raportet e Auditimeve të rregullsisë të kryera nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) dhe Raportit Vjetor të Auditimit (RVA) për vitin 2014 dhe 2015.

Sipas RVA-së të vitit 2014, në nivel komunal konsiderohet si sfidë bashkëfinancimi i projekteve sipas marrëveshjeve me donatorë të ndryshëm. Meqë projektet e tilla nuk monitorohen nga komunat, ka raste që mungojnë informacionet nëse donatori është duke implementuar projektet sipas marrëveshjeve.

Ne kemi pranuar pyetësorët nga komunat ku janë identifikuar parregullsitë edhe në aspektin e regjistrimit të donacioneve të cilat nuk kanë kaluar përmes thesarit si dhe nuk ka ndonjë procedurë apo udhëzues për menaxhimin e procesit të donacioneve nëpër komuna.


Më pas është vërejtur se në Ministrinë e Integrimeve Evropiane (MIE) ekziston Platforma për Menaxhimin e Ndihmës së donacioneve (PMN) ku kemi identifikuar se të dhënat e raportuara nga ana e donatorëve nuk ofrojnë një pamje të qartë dhe të saktë të financimeve.

Sipas raportit të publikuar në “Global Partnership”, vërehet ndryshim i lartë i disbursimeve krahas atyre të planifikuara.

---

<sup>4</sup>ligji nr. 04/1-052 për marrëveshjet ndërkombëtare

## Grafiku 2. Paraqitja e shpërndarjes së donacioneve sipas planifikimit



\*Vlerësim i auditimit

Burimi: Raporti "Global Partnership"

Sipas grafikut të paraqitur më lartë vërehet se përveç disbursimeve që nuk janë bërë sipas planifikimit, disbursimet janë bërë edhe përtej planifikimit.

Përveç tjerave, gjatë analizave tona gjatë fazës së parastudimit kemi vërejtur edhe parregullsitë në aspektin e raportimit të donatorëve në MIE si:

- Shpërndarja e donacioneve nuk përmban informata për projekte specifike;
- Nuk ka informata të plota për zotimet/shpërndarjet nga donatorët;
- Shpërndarjet janë më të mëdha se zotimet, dhe
- Raportimet nga donatorët nuk janë të plota.

## Objektiva e auditimit

Objektivë e këtij auditimi është vlerësimi i procesit të bashkëfinancimit të sektorëve sipas prioriteteve të përcaktuara në programin qeveritar, koordinimin me donatorët, implementimin, monitorimin, si dhe nëse është arritur qëllimi i synuar për investimet e bëra.

---

## Pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektivës së auditimit ne kemi parashtruar pyetjet audituese si në vijim:

- A është duke funksionuar sistemi i mbikëqyrjes dhe koordinimit të marrëveshjeve të bashkëfinancimit siç duhet, dhe nëse jo si mund të përmirësohet?
- A janë menaxhuar siç duhet marrëveshjet e bashkëfinancimit për të arritur qëllimin, nëse jo pse?

## Kriteret e auditimit

Për përcaktimin e kriterëve jemi bazuar në dokumentin e Programit Qeveritar, legjislacionin kombëtar primar dhe sekondar, si dhe praktikën e mira për menaxhimin e marrëveshjeve të bashkëfinancimit në shtetet perëndimore me qëllim të përmirësimit të kualitetit të asistencës së jashtme.

Kriteret për pyetjen e parë audituese janë:

- Qeveria përmes grupeve punuese duhet të ofroj informata dhe të prezantoj prioritet kombëtar para donatorëve të huaj<sup>5</sup>;
- Financimet nga donatorët duhet të jenë në harmoni me programin qeveritar, në bazë të prioritetëve të përcaktuara sipas ndarjes sektoriale<sup>6</sup>;
- Raportimi dhe monitorimi i akterëve përgjegjës duhet të jetë i harmonizuar, të ketë udhëzues/rregullore të raportimit, apo edhe në bazë të marrëveshjeve duke specifikuar qartë kushtet dhe kriteret mbi transferet financiare me rastin e kryerjes së punimeve dhe kompletimit të dokumentacionit për projektet përkatëse<sup>7</sup>;
- Akterët përgjegjës, MIE në cilësinë e sekretariatit si organizatore e takimeve të grupeve punuese duhet të bëjë matjen e rezultateve të aktiviteteve që kryejnë si dhe të raportojë lidhur me implementimin dhe monitorimin e projekteve të bashkëfinancimit si dhe rezultatet e arritura<sup>8</sup>;

Kriteret nga Deklarata e Parisit (2005), sipas Agjendës "Accra" e cila përcakton parimet për menaxhimin e donacioneve në shtetet perëndimore me qëllim të përmirësimit të kualitetit të asistencës së jashtme janë:

---

<sup>5</sup> Rregullore 04/2011 për koordinimin e donatorëve deri në vitin 2015, rregullore 09/2015 për koordinimin e asistencës së donatorëve të jashtëm

<sup>6</sup> Rregullore 04/2011 për koordinimin e donatorëve deri në vitin 2015, rregullore 09/2015 për koordinimin e asistencës së donatorëve të jashtëm

<sup>7</sup> Marrëveshjet Ndërkombëtare, zotimi në mes akterëve mbi kushtet dhe përgjegjësitë në marrëveshje

<sup>8</sup> Rregullore 04/2011 për koordinimin e donatorëve deri në vitin 2015, rregullore 09/2015 për koordinimin e asistencës së donatorëve të jashtëm

---

- Komunikimi dhe bashkëpunimi në mes të akterëve janë të bazuar në sistemet funksionale, transparencë dhe llogaridhënie të ndërsjellët;
- Pronësia: vendet në zhvillim vendosin strategjitë e tyre për reduktimin e varfërisë, përmirësimin e institucioneve të tyre dhe trajtimin e korrupsionit; dhe
- Harmonizimi: vendet donatore koordinojnë, thjeshtësojnë procedurat dhe shpërndajnë informatat për të ju shmangur dyfishimit të përkrahjeve nga donatorët.

Ndërsa kriteret për pyetjen e dytë audituese janë:

- Marrëveshjet e nënshkruara në mes të akterëve duhet të përmbajnë kriteret të qarta dhe të mjaftueshme në mënyrë që të sigurohet se janë duke u kryer obligimet me kohë si dhe sigurojnë një mbarëvajtje të gjithë procesit të implementimit të projekteve<sup>9</sup>;

Kriteret nga Deklarata e Parisit (2005), sipas Agjendës “Accra” e cila përcakton parimet për menaxhimin e donacioneve në shtetet perëndimore me qëllim të përmirësimit të kualitetit të asistencës së jashtme janë:

- Mbarëvajtja: vendet donatore qëndrojnë prapa këtyre objektivave dhe përdorin sistemet lokale;
- Rezultatet: Vendet në zhvillim dhe donatorët zhvendosin fokusin e tyre në rezultate zhvillimore dhe rezultatet janë të matshme; dhe
- Llogaridhënia reciproke: Donatorët dhe partnerët janë llogaridhënës për zhvillimin e rezultateve.

---

<sup>9</sup> Marrëveshjet Ndërkombëtare, zotimi në mes akterëve mbi kushtet dhe përgjegjësitë në marrëveshje

---

---

## Fushëveprimi dhe Metodologjia e auditimit

Për të vlerësuar menaxhimin e marrëveshjeve të bashkëfinancimit ne kemi përzgjedhur MIE si përfaqësuese e Qeverisë për zbatimin e një sistemi të mirëfillt për planifikimin, koordinimin dhe menaxhimin e ndihmës së jashtme, Ministrinë e Financave (MF) si vlerësues i ndikimit buxhetor (VNB) për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) si nënshkruese e marrëveshjes së bashkëfinancimit për realizimin e projektit për ndërmarrjet publike (NP) në cilësinë si pronare dhe monitoruese e NP-ve si dhe përfituesit e projekteve: Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjinë (MASHT), Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), NP të ujërave "Hidromorava" dhe "Hidro regjioni jugor", Komunën e Prizrenit, Gjakovës, Fushë Kosovës dhe Prishtinës. Përzgjedhja e projekteve audituese në nivelin qendror dhe lokal është bërë sipas prioriteteve të programit qeveritar që është i ndarë në sektorë. Ky auditim do të mbulojë auditimin e marrëveshjeve të bashkëfinancimit me donatorët e jashtëm për periudhën 2014 -2016.

Për të kryer auditimin dhe për t'iu dhënë përgjigje pyetjeve auditues ne kemi analizuar dokumentet, legjislacionin dhe praktikat relevante, përpiluar dhe përdorur pyetësor për marrëveshjet e bashkëfinancimit dhe intervistuar palët përgjegjëse. Në kuadër të këtij auditimi ne kemi analizuar:

- Rregulloren për procesin e koordinimit, monitorimit, raportimit dhe vlerësimin e asistencës së donatorëve;
  - Marrëveshjet e nënshkruara në mes donatorëve dhe institucioneve përfituese;
    - ✓ Marrëveshjen e Luksemburgut (Shëndetësi, Arsimi dhe aftësi profesionale) auditimi është shtrirë në MSH dhe në MASHT;
    - ✓ Marrëveshjen e Qeverisë së Zvicrës (auditimi do të shtrihet tek MZHE dhe NP " KRU "Hidromorava" në Gjilan dhe "Hidro regjioni jugor" në Prizren si dhe
    - ✓ Marrëveshjet e nënshkruara ne nivelin lokal tek komunat përkatëse (Prizren, Gjakovë, Fushë Kosovë dhe Prishtinë)
  - Kornizën ligjore ekzistuese për inicimin dhe lidhjen e marrëveshjeve;
  - Intervista me zyrtarët përgjegjës për planifikimin, koordinimin, regjistrimin dhe raportimin e donacioneve;
  - Analizimi i proceseve, procedurave ekzistuese që janë vendosur për menaxhimin dhe implementimin e projekteve;
  - Rishikimi i kontrolleve kyçe të zbatuara nga Institucionet relevante dhe zyrtarëve llogaridhënës në lidhje me menaxhimin e projekteve;
  - Rishikimi dhe analizimi i dokumenteve që ndërlidhen me realizimin e projekteve;
  - Vlerësimi nëse mjetet janë shfrytëzuar për çka janë destinuar; dhe
  - Ekzaminimi fizik i projekteve.
-

## 2 Përshkrimi i sistemit për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëfinancimit me donatorët

### 2.1 Lidhja e marrëveshjeve me donatorët në nivelin qendror Qeveri-Qeveri

Ligji për marrëveshjet ndërkombëtare përcakton procedurën e lidhjes, nënshkrimit, ratifikimit, si dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës. Kompetenca për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare kanë Presidenti, Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme, dhe e kanë të drejtën e kryerjes së të gjitha veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës.

Marrëveshjet ndërkombëtare të cilat kanë implikime financiare kalojnë nëpër një vlerësim nga MF/Departamenti për buxhet, dhe përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve dhe ratifikohen me ligj. Më poshtë janë të përshkruara disa nga përgjegjësitë që i kanë disa prej palëve kyçe vendore për marrëveshjet e bashkëfinancimit.

#### **Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) si përfaqësuese e institucioneve shtetërore për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare**

- MPJ përfaqëson Kosovën dhe institucionet e saj shtetërore në vendet e jashtme dhe në organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare, përmes ambasadave, misioneve ose zyrave përfaqësuese, të themeluara në pajtim me ligjin e MPJ-së;
- Lidh traktate dhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare me shtetet e tjera dhe vepron në vendet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare në emër të ministrive dhe organeve të tjera shtetërore. Aktivitetet e tilla mund të përfshijnë (por nuk kufizohen në) promovimin e tregtisë dhe investimeve të huaja në Kosovë;
- Depoziton kopjet e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të lidhura në emër të shtetit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës me autoritetet relevante, mban arkiv të atyre traktateve dhe marrëveshjeve si dhe i publikon ato në faqen e internetit të Ministrisë;

#### **MF si Vlerësues i Ndikimit Buxhetor (VNB) për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare**

Departamenti i buxhetit në kuadër të Ministrisë së Financave në bazë të UA nr.03/2015<sup>10</sup> dhe rregullores nr. 02/2011 është i obliguar të jep një opinion të pavarur i cili ka për qëllim verifikimin e vlerësimeve të ndikimit buxhetor për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare që janë me bashkëfinancim.

<sup>10</sup> udhëzim administrativ nr. 03/2015 për vlerësim të ndikimit buxhetor për nismat e reja qeveritare

- 
- Asnjë nismë e re nuk do të miratohet nga qeveria ose nga kreu i organit propozues nëse asaj nuk i është bashkëngjitur formulari i vlerësimit;
  - Bashkërendon me institucionet e administratës publike dhe sipas nevojës, me donatorët multilateralë e bilateralë për çështjet që kanë të bëjnë me financimin nga donatorët dhe kontributet e dhuruara;
  - Siguron përdorimin efektiv dhe transparent të fondeve të donatorëve për qëllimet e akorduara; dhe
  - Bashkërendon dhe koordinon aktivitetet e institucioneve ndërkombëtare financiare.

#### **MIE - si përgjegjëse për koordinimin me donatorët dhe asistencën e jashtme**

- Koordinon ndihmën e jashtme në nivel të Republikës së Kosovës, në raport me donatorët përmes instrumenteve të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe prezantimin e prioriteteve të qeverisë para donatorëve të jashtëm;
- Koordinon programimin, planifikimin, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e asistencës së donatorëve;
- Në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha ministritë, koordinon të gjitha aktivitetet e donatorëve në nivel sektorial dhe nën-sektorial, duke siguruar që këto ndihma të jenë në harmoni të plotë me prioritetet zhvillimore, si dhe të jenë të ndërlidhura sa më shumë që është e mundur me dokumentet strategjike në mënyrë që të arrihet efektivitet më i lartë i këtyre ndihmave.

## **2.2 Lidhja e marrëveshjeve në nivelin lokal Komunë-Donatorë**

Përgjegjësitë e Komunës duhet të ushtrohen, organizohen dhe menaxhohen në pajtueshmëri të plotë me ligjet të cilat rregullojnë përgjegjësitë e komunës, Ligjin e Buxhetit, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike, rregulloret dhe procedurat e punës në pajtueshmëri me Statutin e Komunës të miratuar nga Kuvendi i Komunës.

Komunat si përfituese të donacioneve kanë përgjegjësitë e tyre për lidhjen e marrëveshjeve, implementimin dhe monitorimin e projekteve në bazë të udhëzuesve apo rregulloreve, si dhe kushteve dhe kritereve të parapara në marrëveshjet e lidhura në bashkëpunim me donatorët.

Komunat mund të vendosin procedura, apo udhëzues për një qasje më atraktive dhe transparente për lidhjen e marrëveshjeve me donatorët.

Në disa raste, Komunat me qëllim të promovimit dhe prezantimit të prioriteteve të tyre organizojnë takime, konferenca me donatorë të ndryshëm, në mënyrë kjo e inicimit të lidhjes së marrëveshjeve për bashkë financim.



### 3 Gjetjet e auditimit

Në këtë kapitull, kemi paraqitur gjetjet që ndërlidhen me akterët kryesor që kryejnë planifikimin, koordinimin, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e asistencës së donatorëve dhe institucioneve si përfituese të donacioneve, dhe realizimin e projekteve të tyre. Ky raport është i strukturuar në tre grupe që përmbajnë:

- Procedurat e koordinimit të ndihmës së jashtme në Kosovë, duke përfshirë këtu edhe prezantimin e prioriteteve të qeverisë para donatorëve të jashtëm, gjendja dhe gjetjet e auditimit janë të prezantuara në kapitullin 3.1
- Procesin e vendosjes së prioriteteve, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin mbi zbatimin e projekteve të asistencës së donatorëve, gjendja dhe gjetjet e auditimit janë të prezantuara në kapitullin 3.2 si dhe
- Në kapitullin 3.3 janë paraqitur gjetjet e auditimit lidhur me menaxhimin dhe realizimin e projekteve nga ana e përfituesve.

#### 3.1 Menaxhimi i informacionit për bashkëfinancimet me donatorët

Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të ketë informacion të saktë dhe të plotë për të gjitha marrëveshjet e bashkëfinancimeve me donatorët. Informatat e sakta dhe të plota do t'i siguronin qeverisë një bazë të mirë për vendimmarrje dhe njëkohësisht do të ruanin kredibilitetin ndaj donatorëve. Për të arritur këtë, qeveria duhet të ketë një bazë të të dhënave për të gjitha marrëveshjet e bashkëfinancimit, si dhe do të ishte e nevojshme të përcaktohej një institucion qeveritar. Ky institucion do të barte përgjegjësinë për instalimin dhe administrimin e një baze të dhënash duke përfshirë të gjitha marrëveshjet e bashkëfinancimit duke u nisur nga ato të cilat janë realizuar, atyre që janë në proces apo edhe të atyre që janë nënshkruar por për arsye të ndryshme nuk janë realizuar.

Për të arritur këtë qëllim, do të jetë e nevojshme të merret informacion mbi ndihmën e huaj nga të dyja palët, si nga donatorët po ashtu dhe nga institucionet përfituese qeveritare.

Lidhur me raportimin në institucionet qeveritare ne kemi identifikuar mangësitë/ gjetjet e auditimit si në vijim:

Në nivel qeveritar deri më tani nuk është përcaktuar një institucion i cili do të administronte një bazë të të dhënave për të gjitha marrëveshjet e bashkëfinancimit të cilat janë të ratifikuara nga Kuvendi i Kosovës. Në legjislacionin aktual nuk është e definuar se përgjegjësi e cilit institucion është mirëmbajtja dhe administrimi i bazës së të dhënave. Aktualisht dy institucione kyqje Ministria e Integritetit Evropian (MIE) dhe Ministria e Financave (MF) kanë disa informata lidhur me marrëveshjet e bashkëfinancimit bazuar në të dhënat nga burime të ndryshme, mirëpo këto të dhëna nuk korrespondojnë me njëra tjetrën dhe nuk e paraqesin një gjendje të plotë me të gjitha ndarjet sipas kategorive të financimit sic janë: kredi, hua dhe marrëveshje të bashkëfinancimit.

Nga viti 2009 deri më tani për të gjitha kategoritë, Kuvendi dhe Presidenca kanë ratifikuar rreth 300 marrëveshje financiare.

MIE përgatit dhe prezanton të dhënat në raportin vjetor të donatorëve bazuar në të dhënat nga Platforma për Menaxhimin e Ndhmës, ndërsa MF përgatit Raportin Vjetor Financiar të buxhetit të Kosovës në bazë të dhënave të prezantuara në pasqyrat financiare nga Organizatat buxhetore (OB) tek pjesa e granteve të përcaktuara nga donatorët. Në këtë kapitull të raportimit është e shpalosur në mënyrë të përgjithshme gjendja e granteve të pranuar nga donatorët, mirëpo nuk është e ndarë në mënyrë specifike cdo kategori e granteve, ndarje e cila do të pasqyronte një gjendje të plotë dhe të saktë, do të lehtësonte menaxhimin e marrëveshjeve të bashkëfinancimit si dhe do të pasqyronte raportim më të mirë për nevoja të brendshme dhe të jashtme.

Sa i përket marrëveshjeve të bashkëfinancimit, nuk kemi arritur të sigurojmë një bazë të dhënave nga institucionet relevante MPJ, MIE dhe MF apo nga Kuvendi mbi marrëveshjet e lidhura për vitet 2014-2016. Në mungesë të kësaj baze të dhënave ne kemi siguruar këto të dhëna përmes gazetës zyrtare që na ka shërbyer edhe për përcaktimin e mostrimit, apo institucioneve të cilat do të jenë pjesë e auditimit. Sipas informatave në gazetën zyrtare për periudhën 3 vjecare janë nënshkruar njëzet e katër marrëveshje për të gjitha kategoritë e financimit, ndërsa për bashkëfinancim janë vetëm tri marrëveshje.

Mungesa e informatave të plota dhe të sakta lidhur me bashkëfinancimet ndikon në vendimmarrje jo të drejtë dhe rritë rrezikun për dyfishimin e financimit në sektorë njëjtë. Më tutje, zbehë llogaridhënien dhe transparencën lidhur me menaxhimin e ndihmës së huaj.

### 3.2 Koordinimi i MIE me institucionet tjera për marrëveshjet e bashkëfinancimit

Sipas praktikave të mira të shteteve anëtare në "Global Partnership"/rrjetit Evropian për Asistencë të jashtme, Institucionet Qeveritare<sup>11</sup> duhet të angazhohen në udhëheqjen dhe menaxhimin e ndihmës së huaj nëpërmjet koordinimit të të gjitha ministrive. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e raportimit dhe regjistrimit të ndihmës së huaj, dhe lidhjen e saj me buxhetin dhe programin qeveritar.<sup>12</sup>

MIE si përgjegjëse për koordinimin e ndihmës së jashtme duhet të sigurojë që këto ndihma të jenë në harmoni të plotë me prioritetet zhvillimore, si dhe të jenë të ndërlidhura sa më shumë që është e mundur me dokumentet strategjike në mënyrë që mos të krijohet dyfishimi me fonde të donatorëve të tjerë.

<sup>11</sup> MIE, MF dhe MPJ

<sup>12</sup> Dokumenti i orientimit të ndihmës së huaj, Republika e Shqipërisë, faqe 59 (Prill 2008)

---

Lidhur me koordinimin ne kemi hasur mangësitë/ gjetjet e auditimit si në vijim:

Nga analizat që kemi bërë në data bazën PMN kemi konstatuar se jo të gjitha projektet janë në harmoni të plotë me prioritetet zhvillimore. Po ashtu, raportet vjetore të donatorëve të përgatitura nga MIE nuk japin informata mjaft të qarta për të identifikuar saktë financimin sipas sektorëve. Sipas raportit vjetor të donatorëve nga MIE të vitit 2015, nga 772 projekte të donatorëve 229 e tyre apo 33.5 % ishin prezantuar në sektorin “të tjera” ku përfshihen projektet të cilat janë në dy e më shumë sektorë. Mos definimi i qartë i sektorëve të financuar shkakton paqartësi në identifikimin e sektorëve të financuar, respektivisht raportimin e qartë të sektorëve të financuar nga donatorët.

Rregullorja për koordinimin e asistencës së donatorëve të jashtëm nga MIE përcakton bashkërendimin, programimin dhe harmonizimin e prioritetëve kombëtare. Duke pas parasyshë rolin e MIE si koordinatorë e të gjitha ministrive për përkrahjen nga jashtë, nuk ka përgatitur një dokument për përcaktimin e projekteve me prioritet, dokument ky që do të vlerësoj nëse projekt propozimet janë në harmoni me prioritetet e programit qeveritar.

Po ashtu, MIE nuk ka hartuar formate apo metodologji për të udhëzuar të gjitha ministrinë e linjës mbi procesin e përgatitjes dhe dorëzimit të projekteve për financim gjë që do ti ndihmonte institucionet në hartimin dhe priorizimin e projekteve në harmoni me prioritetet qeveritare.

### 3.3 Roli i MIE për funksionimin e grupeve punuese për përcaktimin e prioritetëve

Koordinimi, monitorimi, vlerësimi dhe raportimi i donacioneve në Kosovë rregullohet në bazë të rregullores mbi koordinimin e donatorëve<sup>13</sup>. Qëllimi i kësaj rregullore është koordinimi i ndihmës së jashtme, krijimin e një sistemi që siguron efektivitetin dhe transparencën në mes të aktiviteteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komunitetit të Donatorëve.

Bazuar në rregulloren për koordinimin e donatorëve të jashtëm përgjegjësitë, detyrat dhe mënyra e funksionimit të grupeve punuese të Forumit të Nivelit të Lartë (FNL) dhe Grupeve Punuese Sektoriale (GPS) duhet të rregullohet me akte të brendshme normative nga MIE, ndërsa për funksionimin e Grupeve Punuese Nën Sektoriale (GPNS) të rregullohet me akte të brendshme në kuadër të organizatave.

Sipas kësaj rregullore, MIE si organ përgjegjës për koordinim, shqyrtim dhe mbikëqyrje të progresit të ndihmës për projektet të ndërlidhura me strategjitë sektoriale ka paraparë themelimin e këtyre grupeve punuese:

---

<sup>13</sup> Rregullore nr.04/2011 për koordinimin e donatoreve,  
Rregullore nr.09/2015 për koordinimin e asistencës së donatoreve të jashtëm në Republikën e Kosovës

---

**Forumi i Nivelit të Lartë (FNL)** është struktura më e lartë për koordinimin e asistencës së donatorëve të jashtëm në Republikën e Kosovës që diskuton prioritetet kombëtare për financim nga asistenca e donatorëve të jashtëm dhe treguesit kryesorë të monitorimit të asistencës së jashtme në nivel kombëtar si dhe inicion diskutimet në nivelin më të lartë me donatorët e jashtëm sa i përket politikave dhe strategjive zhvillimore.

**Grupet Punuese Sektoriale (GPS)** janë struktura për koordinimin dhe harmonizimin e asistencës së donatorëve të jashtëm me prioritetet kombëtare, për monitorimin e asistencës së donatorëve të jashtëm duke bazuar në treguesit e miratuar në nivel sektorial dhe iniciuar diskutimet me donatorët e jashtëm sa i përket politikave dhe strategjive sektoriale.

**Grupet Punuese Nën-Sektoriale (GPNS)** janë struktura për koordinimin e asistencës së donatorëve të jashtëm, me karakter teknik dhe operativ në kuadër të organizatave, të nën sektorëve dhe mandati i tyre është koordinimi dhe monitorimi i aktiviteteve të donatorëve të jashtëm në nën sektor të veçantë, duke siguruar realizimin e konkluzioneve të arritura në takimet e FNL dhe GPS.

Lidhur me funksionimin e grupeve punuese kemi identifikuar mangësitë/ të gjeturat si në vijim:

MIE në cilësinë e sekretariatit që ushtron për grupet punuese FNL dhe GPS, nuk ka hartuar një dokument apo rregullore mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këtyre grupeve punuese, që përgatit takimet, raportet dhe prezantimet për prioritetet e RKS-së për asistencën e jashtme dhe përcjelljen mbi zbatimin e konkluzioneve të arritura. Po ashtu, GPNS-të nuk janë plotësisht funksionale sipas akteve normative në kuadër të ministrive.

FNL edhe përkundër kërkesave ligjore të parapara që duhet të mbahet së paku një takim në vit, nuk ka mbajtur takime gjatë vitit 2014 dhe 2016, përveç se gjatë vitit 2015 është mbajtur një takim ku janë diskutuar aktivitetet e donatorëve dhe është prezantuar Projekt-Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe prioritetet kryesore të zhvillimit të Qeverisë së RKS-së. Përveç këtij takimi, FNL nuk ka mbajtur takime tjera të rregullta me grupet punuese.

GPS edhe përkundër kërkesave ligjore të parapara që duhet të mbahen së paku dy takime në vit, nuk ka mbajtur asnjë takim gjatë vitit 2014 dhe 2015, përveç se gjatë vitit 2016 është mbajtur një takim, ku janë diskutuar aktivitetet e donatorëve dhe implementimi i projekteve që janë në proces e sipër. Në këto takime GPS do të duhej të përcaktojnë prioritetet vjetore dhe shumë vjeçare për financim nga asistenca e jashtme në nivel të sektorëve.

GPNS edhe përkundër kërkesave ligjore të parapara që ato të udhëhiqen dhe organizohen nga Ministritë, Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP).

Gjatë auditimit tonë ne kemi identifikuar se në dy ministri, sic është rasti me MSH dhe MASHT, përkatësisht DIEKP në cilësinë e sekretariatit, nuk kanë funksionuar dhe mbajtur takimet e tyre të rregullta në MSH. Kjo ministri në vitin 2015 ka aprovuar një qarkore informative që ka për qëllim zbatimin e rregullores së qeverisë për koordinimin me donatorët, krijimin e një sistemi që siguron efektivitetin dhe transparencën mes MSH dhe komunitetit të donatorëve. Sipas kësaj qarkore të gjitha institucionet shëndetësore dhe komuniteti i donatorëve duhet ta informojë DIEKP në ministri me rastin të inicimit/pranimin të ndonjë donacioni.

Ndërsa, sa i përket MASHT edhe përkundër mungesës së ndonjë akti apo qarkore të brendshme ka organizuar takime të rregullta me donatorë në nivel sektorial dhe nën-sektorial (arsimi para universitar, arsimi profesional dhe arsimi i lartë), ku është raportuar mbi projektet e donatorëve, prioritetet dhe aktivitetet e kësaj ministrie.

Mungesa e akteve të brendshme normative ka shkakuar mos mbajtjen e takimeve të rregullta dhe mos funksionimin e grupeve punuese FNL dhe GPS. Si pasojë nuk është përgatitur, miratuar dhe prezantuar plani vjetor për koordinimin e ndihmës së donatorëve të jashtëm.

### 3.3.1 Sistemi i integruar i koordinimit të monitorimit, vlerësimit dhe raportimit të financimeve Qeveri-Donatorë dhe zotimet e tyre

Monitorimi/vlerësimi dhe raportimi është proces shumë i rëndësishëm i cili varet nga të dhënat, mjetet e verifikimit, burimet e mundshme të dhënave që do të shfrytëzohen dhe metodologjitë që do të përdoren. Ky proces duhet të organizohet në nivel institucional ku po thuajse secili institucion krijon sistemet e brendshme të monitorimit dhe raportimit, dhe po ashtu duhet të ekzistoj një plan për integrimin e këtyre sistemeve, që kërkon vendosjen e një Sistemi të Integruar të Menaxhimit të Informatave që do të mbulonin të gjitha zotimet qeveritare dhe ato të donatorëve. Procesi efikas i monitorimit dhe vlerësimit ofron pasqyrë të qartë rreth arritjes së rezultateve dhe objektivave të synuara. MIE në cilësinë e sekretariatit mbi koordinimin e donatorëve është përgjegjëse për vlerësimin e asistencës së jashtme.

Lidhur me sistemin e monitorimit të integruar dhe përcaktimin e indikatorëve ne kemi identifikuar mangësitë/gjetjet e auditimit si në vijim:

Përgjegjësi e FNL-së është që të përcaktojë treguesit kryesorë për monitorimin e asistencës së jashtme në Kosovë për të gjithë sektorët dhe arritjen e konkluzioneve. MIE gjegjësisht FNL nuk kanë përcaktuar indikatorë për të matur rezultatet dhe përpiluar raporte mbi vlerësimet e grupeve punuese sektoriale dhe grupeve punuese nën sektoriale.

MIE nuk ka përgatitur ndonjë plan të integruar të monitorimit dhe vlerësimit i cili do të përkrah llogaridhënien dhe raportimin e aktiviteteve të realizuara dhe përputhjes së tyre me objektivat e përcaktuara dhe zotimet e bëra nga të dy palët. Po ashtu, MIE nuk ka prodhuar ndonjë raport të integruar të monitorimit për të gjitha institucionet që do të mbulonin të gjitha zotimet qeveritare dhe ato të donatorëve në raport me objektivat e caktuara.

### 3.3.2 Raportimi dhe Llogaridhënia

Raportimi cilësor dhe efektiv duhet të përmbush disa kritere për të siguruar shfrytëzueshmërinë e tij, të përmbajë të dhëna të rëndësishme dhe të dobishme, të jetë në kohë dhe të sigurojë sasi të mjaftueshme të informacionit për përdorimin e synuar. Veçanërisht është e rëndësishme që përmbajtja e raportimit të përfshijë edhe kërkesa tjera specifike, të jetë i saktë, koherent dhe i përshtatshëm për shfrytëzuesit.

Aktualisht MIE administron PMN-në, një sistem online përmes të cilit siguron raportimin për menaxhimin e ndihmës nga jashtë. Kjo platformë është në funksion që nga viti 2009 dhe mundëson që secili donator të regjistroj informacione mbi zotimet dhe disbursimet e fondeve në intervale mujore, tremujore dhe vjetore. Si rezultat i kësaj, MIE harton raportin vjetor të koordinimit të donatorëve që ofrojnë një përmbledhje të efikasitetit të ndihmës së jashtme në krahasim me prioritetet zhvillimore të Kosovës.

Lidhur me raportimin ne kemi identifikuar mangësitë/gjetjet e auditimi si në vijim:

MIE harton raportin vjetor të koordinimit të donatorëve, që ofron të dhëna përshkruese të gjendjes së financimeve nga donatorët dhe shpërndarjen e tyre sektoriale si dhe një llogaritje të përgjithshme të financimit të pranuar nga komunitat e përfshira.

Më poshtë në tabelën 1 dhe 2 është shpalosur shpërndarja e donacioneve sipas prioriteteve qeveritare për vitet 2014 dhe 2015.

**Tabela 1. Shpërndarja e donacioneve sipas prioriteteve qeveritare për vitin 2014**

<b>Viti 2014</b>				
<b>PRIRORITETI I QEVERISE</b>	<b>TE ZOTUARA</b>	<b>% E TOTALIT</b>	<b>TE DISBURSUARA</b>	<b>% E TOTALIT</b>
Zhvillimi Ekonomik, Punesimi dhe Mirëqenia	53,536,745	30	87,914,859	42
Sundimi i Ligjit	121,742,112	64	60,119,790	33
Agjenda evropiane dhe politika e jashtme	-	-	-	-
Arsimi, Shkenca, Kultura, Rinia & Sporti	14,052,665	7	29,556,443	16
Kujdesi shendetesor modern	2,312,739	1	3,809,201	2
<b>Totali</b>	<b>191,644,261</b>	<b>100</b>	<b>181,400,283</b>	<b>100</b>

\*Vlerësim i auditimit

Burimi: Raporti vjetor i donatorëve MIE, 2014

**Tabela 2. Shpërndarja e donacioneve sipas prioriteteve qeveritare për vitin 2015**

<b>Viti 2015</b>				
<b>PRIORITETI I QEVERISE</b>	<b>TE ZOTUARA</b>	<b>% E TOTALIT</b>	<b>TE DISBURSUARA</b>	<b>% E TOTALIT</b>
Zhvillimi Ekonomik, Punesimi dhe Mirëqenia	71,328,322	36	102,490,160	49
Sundimi i Ligjit	55,571,183	28	44,776,635	22
Arsimi, Shkenca, Kultura, Rinia & Sporti	16,072,204	8	11,669,432	6
Kujdesi shendetesor modern	3,824,362	2	5,250,964	3
Shume- sektorial dhe Nder -sektorial	52,167,472	26	4,379,808	21
<b>Totali</b>	<b>198,963,543</b>	<b>100</b>	<b>207,980,999</b>	<b>100</b>

\*Vlerësim i auditimit

Burimi: Raporti vjetor i donatorëve, MIE 2015

---

Për dallim nga vitet 2014 dhe 2015, raporti vjetor i donatorëve për vitin 2016 është përgatitur në sektorë e nën sektor për të detajuar më tej fushat e ndihmës zyrtare zhvillimore ( sipas OECD ka 25 sektorë dhe të gjithë ata kanë marrë shkallë të ndryshme financimi gjatë vitit 2016)<sup>14</sup>.

Për dallim nga sistemi i mëparshëm i raportimit, mënyra e raportimit për vitin 2016 është bazuar në grupet punuese të donatorëve të Kosovës, nga fakti se një sasi e konsiderueshme e financimit është raportuar në sektorin "të tjera", ku përfshihen projekte të rëndësishme që nuk bien nën sektorët tjerë operacional të krijuar nga qeveria e Kosovës ( shih. shtojcën 4.)

Sipas raportit vjetor të donatorëve për vitet 2014 dhe 2015 të dhënat e nxjerra nga data baza PMN-ja një shumë e madhe e fondeve i atribuohet sektorit të papërcaktuar "të tjera" ku evidentoheshin financime të ndryshme që nuk i përkasin sektorëve tjerë operacional. Me mënyrën e raportimit të vitit 2016 këto sfida janë tejkaluar ku tani raportohet për 25 sektorë të ndryshëm, mirëpo pavarësisht kësaj forme të raportimit ne kemi konstatuar se sistemi nuk është në gjendje të gjeneroj raporte të grupuara sipas prioriteteve. Kjo gjë na ka pamundësuar të krahasojmë investimet për vitet 2014 dhe 2015 me ato të vitit 2016 që janë bërë për kategori të caktuara dhe nëpër sektor të veçantë siç është zhvillimi ekonomik, arsimit, shëndetësia etj.

Raporti vjetor i përgatitur nga MIE nuk është i plotë, saktë dhe koherent për pasqyrimin e gjendjes së donacioneve. Në raportin vjetorë të përgatitur nga MIE nuk përfshihen të gjitha informatat, nisur nga fakti se në PMN nuk raportojnë të gjithë donatorët, mirëpo bëhet në baza vullnetare. Informatat e PMN-së nuk janë të sakta nga se kemi vërejtur se prezantimi i donacioneve në nivelin qendror jep një pasqyrim të dyfishtë, po ashtu edhe në nivelin lokal siç është rasti i Komunës së Prizrenit, për marrëveshjen e Luksemburgut.

Harmonizimi i raportimit të përbashkët në nivel qeveritar mbi gjendjen e përgjithshme të marrëveshjeve të bashkëfinancimit dhe në përgjithësi të asistencës së huaj nuk është arritur. Megjithatë, MIE dhe MF kanë realizuar disa takime dhe pas përpjekjeve për një bashkëpunim lidhur me paraqitjen e financimeve nga donatorë të huaj, krijimin e një platforme të përbashkët të raportimit me qëllim të harmonizimit të PMN-së me Programin për Investime publike (PIP) dhe Sistemin për Menaxhimin dhe Zhvillimin e Buxhetit (BDMS).<sup>15</sup>

---

<sup>14</sup> Organisation for Economic Co-operation and Development OECD <http://www.oecd.org/about/>

<sup>15</sup> Sipas Deklaratës së Parisit (2005), "Agjenda Accra" vendet në zhvillim vendosin strategjitë e tyre për harmonizimin dhe mbarëvajtjen e donacioneve. Parimi i harmonizimit nisët nga ajo se vendet donatore koordinojnë, thjeshtësojnë procedurat dhe shpërndajnë informatat për t'ju shmangur dyfishimit.

---

## 3.4 Realizimi i projekteve dhe zotimet qeveritare për marrëveshjet e bashkëfinancimit

Qëllimi i përgjithshëm i objektivave të projekteve është përcaktuar në formë të shkruar në Marrëveshjen e Memorandumit (MM) të nënshkruar në mes Qeverisë së një shteti partner në njërin anë dhe Qeverisë së Kosovës/Komunës si partner në anën tjetër, ku përmes realizimit të këtyre projekteve parashihet të arrihet zhvillimi i sektorëve dhe arritja e objektivave në harmoni me prioritetet qeveritare. Me realizimin e këtyre projekteve është synuar zhvillimi i mjekësisë moderne, arsimit dhe aftësisë profesionale (AAP) dhe zhvillimi ekonomik e social, përfitimi i popullatës vendore në zona të caktuara rurale.

Në nivelin qendror ne kemi audituar dy marrëveshje me bashkëfinancim të financuara nga Qeveria e RKS-së dhe Qeverisë së Luksemburgut ku përfitues janë MASHT, MSH si dhe marrëveshjen tjetër në mes Qeverisë së RKS-së dhe Qeverisë së Zvicrrës për projektet kapitale për periudhën 2014-2016, ku përfitues është MZHE në kuadër të së cilës janë dy NP-të, KRU "Hidromorava" në Gjilan dhe "Hidro regjioni jugor" në Prizren.

Ndërsa sa i përket nivelit lokal ne kemi audituar katër Komuna (Prishtina, Prizreni, Gjakova dhe Fushë Kosova) me gjithsej katër projekte të financuara nga donatori dhe Komuna me një përqindje të përcaktuar në bazë të marrëveshjes së lidhur.

Për marrëveshjet e nënshkruara në nivel qendror të institucioneve qeveritare periudha e realizimit të projekteve ishte 3 vjeçare në vlerë prej 29,359,944€ (shih shtojcën 3) ndërsa për ato lokale implementimi i projekteve ishte për periudhë një dhe dy vjeçare, kostoja e këtyre projekteve arrin vlerën prej 4,908,381€ (shih shtojcën 4).

Gjatë procesit të auditimit ne jemi fokusuar në tri shtylla kryesore të Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e që do të paraqesim në vijim.

### 3.4.1 Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, punësimi dhe rritja e mirëqenies së qytetarëve


Zhvillimi ekonomik, promovimi i punësimit dhe rritja e mirëqenies bazohet në iniciativa, konkurrencë dhe treg të hapur, si forcat kryesore që sigurojnë prosperitet ekonomik. Roli i Qeverisë është në ofrimin e kornizës institucionale, brenda së cilës zhvillohen aktivitetet ekonomike, me qëllim të sigurimit të kohezionit të brendshëm të ekonomisë dhe të shoqërisë.

Një ndër qëllimet dhe prioritetet parësore të Qeverisë është edhe zhvillimi ekonomik i vendit. Kosova për vite me radhë ka pranuar numrin më të madh të fondeve të donacioneve me mbi 40% të totalit të zotimeve dhe disbursimeve të donacioneve andaj kjo është arsyeja që jemi fokusuar në këtë shtyllë.



Më poshtë kemi paraqitur grafikun për financimet nga donatorët sipas prioriteteve qeveritare për sektorin e zhvillimit ekonomik.

#### Grafiku 4. Shpërndarja e donacioneve në sektorin e zhvillimit ekonomik krahas donacioneve totale



\*Vlerësim i auditimit

Burimi: Raportet vjetore të donatorëve MIE, vitet 2014, 2015

Sipas grafikut të paraqitur më lartë shihet se shpërndarja e donacioneve në sektorin e zhvillimit ekonomik paraqet një përkrahje të lartë në raport me donacionet e përgjithshme prej 42% në vitin 2014, ndërsa në vitin 2015 me një përkrahje prej 49%.

Qeveria Zvicerrane është në mesin e donatorëve më të mëdhenj në Kosovë. Ky donator është duke zbatuar një program mbështetës për ujë dhe kanalizim në zonat rurale në bashkëpunim me MZHE-në. Projekti tjetër i financuar nga Caritasi Zvicerran i cili në bashkëpunim me Komunën e Gjakovës ka realizuar projektin “Strehimi dhe integrimi i komunitetin Romë, Ashkali dhe Egjiptianë RAE” në lagjen Ali Ibra në Gjakovë.

Po ashtu, sipas raportit të donatorëve për investimet në këtë sektor donatori më i madh në Kosovë është Bashkimi Evropian (BE) i cili ka realizuar disa projekte ndër të cilat edhe projektin “Themelimi i tregut mobil të fermerëve”, projekt ky i realizuar në bashkëpunim me komunën e Prishtinës ku për objektive kryesore kishte rritjen e punësimit.

Në nënkapitullin në vijim kemi shpalosur këto tri projekte dhe gjetjet e auditimit për çdo projekt.

### 3.4.1.1 Marrëveshja e nënshkruar mes Qeverisë së Zvicrës dhe Qeverisë së Kosovës

Që nga viti 2005, qeveria Zvicerrane ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve në zonat rurale në Kosovë përmes 4 fazave të mëparshme të Programit Mbështetës për Ujë dhe Kanalizim në Zonat Rurale në Kosovë.

Përderisa fokus i auditimit tonë është periudha prej vitit 2014 ne kemi marrë marrëveshjen bashkëfinancuese të nënshkruar në vitin 2014 në mes të qeverisë së Zvicrës dhe qeverisë së Kosovës e njohur si faza e V-të e këtij programi, që është në një shkallë më të lartë dhe vazhdimësi e programit nga fazat e mëparshme.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij programi mbështetës për ujësjellës dhe kanalizim në zonat rurale është të kontribuoj në rritjen e qasjes së popullatës së Kosovës në furnizim të duhur me ujë, kanalizim dhe menaxhim të qëndrueshëm të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit. Projekti është financuar nga qeveria e Kosovës me 7,945,604€, ndërsa pjesa tjetër nga Qeveria Zvicerrane, Agjencia Zvicerrane për zhvillim dhe bashkëpunim (AZZHB) në vlerë 11,814,340€ apo në total 19,759,944€. Ndërsa implementimi i projektit do të bëhet nga Community Development Initiatives (CDI). Kohëzgjatja e implementimit të projektit sipas marrëveshjes është për periudhën 2014-2017.

Marrëveshja është implementuar në shtatë kompani të ujërave, prej tyre për mostrim kemi marrë KRU "Hidromorava" Gjilan dhe KRU "Hidro regjioni jugor" në Prizren. Efekti i pritur parasheh zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në shumicën e popullatës në zonat rurale, qëndrueshmërinë e përmirësuar të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe koordinimin e avancuar të gjithë sektorëve.

#### KRU "Hidromorava" në Gjilan

##### Realizimi i projektit

Një ndër përfituesit e këtij projekti është KRU "Hidromorava", faza inicuese e projektit ka filluar në shkurt të 2015. Realizimi i procedurave të prokurimit dhe lidhja e kontratave për implementimin e projektit ka filluar me 25/05/2016 dhe pritet të përfundojë më së largu në mars/2017. Mbulueshmëria e projektit për fazën e V-të përfshinë kryesisht fshatrat e regjionit të Gjilanit me tri fshatra, Novo Bërdë me tetë fshatra, Pasjani me një fshat, Viti me tri fshatra, Ranillugë me dy fshatra dhe Kamenica me katër fshatra.

Realizimi i projektit ka kaluar nëpër këto faza implementuese, ku më poshtë do të shpalosim vlerësimin nga ana jonë bazuar në të dhënat zyrtare dhe raporteve të organizatës KRU "Hidromorava" në Gjilan.

**Objektiva I-rë** parasheh rehabilitimin e rezervuarve për 21 fshatra, projekti është realizuar diku nga 80 deri rreth 95% në 16 fshatra, rreth 10% në Livoc të ultë dhe 50% në Topancië ndërsa në tri fshatrat e tjera nuk janë realizuar fare.

**Objektiva II-të** parasheh rehabilitimin e stacionit të pompimit për 19 fshatra, projekti është realizuar për 11 fshatra nga 50 deri në 90%, ndërsa në 8 fshatra tjera punimet nuk kanë filluar fare, për arsye se shumica e këtyre sistemeve mirëmbajtja është bërë nga vet banoret e këtyre fshatrave dhe kanë hasur në rezistencë të banorëve.

Kjo ka shkaktuar probleme gjatë qasjes në ato sisteme të ujësjellësve në ato fshatra dhe për pasojë kanë shkaktuar vonesa në realizimin e projektit.

**Objektiva III-të** parasheh rehabilitimin e sistemeve të dezinfektimit të ujit, kjo objektivë nuk ka filluar ende të implementohet pasi që konsiderohet se punimet mund të fillojnë pas përfundimit të dy objektivave të para.

Sipas planit dinamik është paraparë që punimet të kryhen brenda 230 ditëve, afati i fundit për përfundimin e projektit ishte paraparë deri në mars/2017, ndërsa punimet ende janë duke vazhduar.

Sipas raporteve zyrtare projekti nuk është duke u implementuar sipas planit të paraparë dinamik në MM. Projekti ka hasur në vështirësi të realizimit për shkak të kushteve atmosferike, të pronësisë, ujërave të zeza, energjisë elektrike apo edhe arsyeve të tjera, si rezistenca e banorëve.

Kompania "Hidromorava" si organ mbikëqyrës ka kontraktuar kompaninë private e cila e monitoron realizimin e punimeve dhe raporton te menaxheri i projektit të KRU "Hidromorava", mbi rrjedhjen dhe ecurinë e punimeve. Sa i përket realizimit të projektit kompania e kontraktuar si organ mbikëqyrës ka bërë raporte ditore në vazhdimësi mbi punët që janë duke u kryer, raporte këto me të dhëna shumë të thjeshta pa ndonjë sqarim apo arsyetim të mundshëm në rast ndërprerje apo mos realizim të punimeve.

Nuk ka përgatitur raporte periodike që ofrojnë informata të sakta, relevante dhe në kohë lidhur me progresin drejt arritjes së planit të paraparë, në mënyrë që të rrisë llogaridhënien për burimet e përdorura dhe për rezultatet e arritura. Këto raporte me tepër janë përshkruese.

Në bazë të gjendjes që ne kemi verifikuar vijmë në përfundim se për objektivën e parë nga gjithësejt 21 fshatra punimet nuk janë realizuar në tërësi për 18 fshatra ndërsa në tri fshatra nuk kanë filluar punimet fare. Sa i përket objektivës së dytë është një nivel jo të kënaqshëm i realizimit të projektit pasi që një numër i konsiderueshëm i fshatrave nuk kanë filluar dhe realizuar punimet e parapara nga gjithësejt 19 fshatra. Projekti është realizuar për 11 fshatra, ndërsa në 8 fshatra tjera punimet nuk kanë filluar fare. Ndërsa realizimi i objektivës së tretë nuk ka filluar ende pasi që konsiderohet se punimet mund të fillojnë pas përfundimit të dy objektivave të para.

## **KRU "Hidroregjioni jugor" Prizren**

### **Realizimi i projektit**

Po ashtu, një ndër përfituesit e tjerë të këtij projekti është KRU "Hidroregjioni jugor", faza inicuese e projektit ka filluar në shtator/2014. Mbulueshmëria e auditimit për vitin 2014- 2016 për fazën e V-

---

të këtijë projekti përfshinë fshatrat e regjionit të Prizrenit (18 fshatra), Dragash (15), Malishevë (11), dhe Suharekë (12) me gjithsejtë 56 fshatra. Realizimi i projektit ka kaluar nëpër këto faza implementuese, ku më poshtë do të shpalosim realizimin e tyre.

**Objektiva I-rë** ndërtimi i sistemeve të reja të ujësjellësve në zonat rurale. Përfitues të këtij projekti janë Komuna e Suharekës dhe Malishevës me fshatra.

Sipas raporteve zyrtare të përgatitura nga menaxheri i projektit ne kemi vlerësuar se në Komunën e Malishevës, punimet janë duke vazhduar me një intensitet më të shtuar, dhe deri tani projekti ka arritur që të realizohet rreth 60%, ndërsa në Komunën e Suharekës punimet janë duke vazhduar me një intensitet tejet të dobët, deri tani kanë arrit të realizohen vetëm 16% e punimeve. Arsyet e ngecjes së projektit bazuar në raportet e menaxherit të projektit janë vështirësitë në përmbushjen e realizimit të punimeve nga Operatori Ekonomik (OE). Kontraktimi i OE është bërë vetëm me vlerësimin e kryer nga ana e komisionit të CDI, pa konsideruar opinionin e komisionit të KRU “Hidroregjioni jugor”. Sipas zyrtarëve të KRU-së përzgjedhja e OE si përfitues i kontratës është vlerësuar si rezultat i çmimit të ofruar më të ultë, çmim i cili ishte jashtë normave të çmimit kushtues (çmimi nën kosto të shërbimit) kjo është arsyeja kryesore e dështimit dhe mos realizimit të punimeve.

Sipas Memorandumit për detyrimet e palëve, mbi Aktivitetet e prokurimit për realizimin e projektit në komunën e Malishevës dhe Suharekës, procedurat duhet të udhëhiqen në bashkëpunim dhe në pajtim të partnereve KRU-CDI. Sipas raporteve të prokurimit për implementimin e këtij projekti shumica e procedurave të prokurimit janë udhëhequr nga KRU, me përjashtim dy prej tyre janë udhëhequr në bashkëpunim mirëpo vendimi për përzgjedhjen e OE është bërë vetëm nga CDI. Partneri implementues CDI nuk ka marr në konsideratë vlerësimin e komisionit përbërës edhe nga KRU “Hidroregjioni jugor” në Prizren të cilit kishin rekomanduar që kontrata mos ti jepet këtij OE për shkak të çmimit tejet të ulët, ku sipas analizave nga ana e KRU-së ky operator nuk do të mund ti mbulojë as shpenzimet e kostos.

Si pasojë, projekti nuk është realizuar sipas planit dinamik, ku është paraparë përfundimi i punimeve në maj/2016, kontrata është ndërprerë me këtë operator dhe janë në proces të shqyrtimit të mundësisë së kontraktimit të një operatori tjetër.

**Objektiva II-të** rehabilitimi i sistemeve të ujësjellësve ekzistues në zonat rurale që vetë menaxhohen

Sipas vlerësimit teknik dhe financiar të sistemeve rurale janë planifikuar të përfshihen afër 100 fshatra kurse numri i fshatrave të përfshira është 56 fshatra: Malishevë (11) Suharekë (12) dhe Prizren (18) si dhe Dragashi (15), ndërsa sa i përket fshatrave tjera nuk janë integruar në këtë sistem.

Sipas raporteve të kompanisë fshatrat tjera nuk kanë shprehë gatishmëri që të jenë pjesë e shfrytëzimit dhe pagesës së shërbimeve të ujit ndaj kompanisë, pasi që këto fshatra deri më tani vetë kanë menaxhuar dhe mirëmbajtur sistemin e ujësjellësit.

**Objektiva III-të** trajtimi i ujërave të përdorura (zeza), pilot projekt, trajtimi biologjik

Si pilot projekt është paraparë të përfshihet trajtimi i ujërave të zeza në fshatin Llukfic, Komuna e Prizrenit dhe janë zhvilluar të gjitha procedurat për implementim të projektit.

---

---

Komuna e Prizrenit në bashkëpunim me kompaninë e ujërave nuk ka arritur marrëveshjen me qytetarët për ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza. Edhe pse janë përfunduar procedurat e shpronësimit të tokës nga Komuna, është hartuar projekti kryesor si dhe është përzgjedhur OE për kryerjen e punimeve. Megjithatë, qytetarët e fshatit Llukfic nuk kanë pranuar të ndërtohet impianti me arsyetimin se është afër vendbanimeve të tyre dhe mund të ketë ndikim negativ në ndotje të ambientit dhe ajrit.

**Objektiva IV-të** sensibilizimi, vetëdijesimi i qytetarëve për rëndësinë e ujit, cilësinë, shfrytëzimin, trajtimin dhe inkasimin

Në kuadër të kësaj objektive janë formuar grupe punuese nga KRU “Hidro regjioni jugor” dhe CDI ku janë mbajtur takime të përbashkëta me komunat dhe fshatrat rreth sensibilizimit të programit, kualitetit të ujit, shfrytëzimit të ujit, dhe ruajtjes së ujit. Ky projekt ka paraparë në baza vullnetare sensibilizimin e qytetarëve e jo duke paraparë si veprim të detyrueshëm. Sipas raportit të vlerësimit teknik të kryer nga KRU “Hidro regjioni Jugor” ky projekt është paraparë të përfshijë 100 fshatra, por deri me tani kanë arritur të sensibilizojnë vetëm 56 fshatra. Ende nuk është arritur sensibilizimi i banorëve të 44 fshatrave të parapara për kyçe në rrjetin e ujësjellësit.

Ndërsa fshatrat e tjera sipas zyrtarëve të KRU-së janë njoftuar verbalisht për implementimin e këtij projekti por nuk ka pasur procesverbale të takimeve sensibilizuese apo njoftime për mbajtjen e tyre.

Për realizimin e të gjitha objektivave të parapara në projekt kanë qenë të kontraktuar disa OE, ku kanë hasur në probleme në implementim sipas planit dhe kanë kërkuar një shtyrje të afatit të punimeve nën arsyetimin e kushteve të papërshtatshme atmosferike dhe pengesave nga banorët.

Raporti i vjetor i progresit është përgatitur në shkurt 2017 nga CDI lidhur me implementimin e projektit në tërësi dhe realizimin për të gjitha kompanitë e ujërave që janë përkrahur nga donatori. Në këtë raport janë paraqitur rezultatet kundrejt objektivave të parapara në nivel të përgjithshëm të projektit. Ky raport ka mjaft informata lidhur me arritjet, vështësitë dhe rreziqet në nivel të përgjithshëm për projektin, mirëpo nuk ka informata individuale për realizimin në përqindje të objektivave në kuadër të cdo KRU-je.

MZHE si pronare dhe përfaqësuese nga Qeveria për nënshkrimin e MM me CDI në rolin mbështetës për përkrahjen e NP-ve ka arritur që ti ndihmojë në përmbushjen e objektivave disa nga NP-të për ngritjen dhe përmirësimin e infrastrukturës publike.

Ministria ka vënë në funksion si mekanizëm kontrolli monitorimin për tu siguruar se projektet e financuara janë duke u realizuar sipas kritereve të parapara në MM. Sipas kësaj marrëveshje janë të parapara mënyra dhe format e raportimit nga ana e CDI-së, si dhe orari dhe mjetet financiare që do të transferohen tek partneri implementues. MZHE ka kryer të gjitha obligimet financiare sipas orarit të paraparë në marrëveshje në bazë të raportimeve të rregullta nga ana e CDI-së.

### 3.4.1.2 Marrëveshja e nënshkruar mes Komunës së Prishtinës dhe Bashkimit Evropian për projektin “Themelimi i Tregut Mobil të Fermerëve” në Prishtinë

Ky projekt është i bazuar në MM të lidhur në dhjetor/2014, midis zyrës së BE-së në Kosovë dhe Komunës së Prishtinës. Palët kryesore të projektit janë Komisioni Evropian, Komuna e Prishtinës, OJQ-të Gratë në Biznes (GnB) dhe Qendra për Ndërmarrësi, si dhe përfituesit e projektit.

Komuna e Prishtinës, GnB dhe Qendra për Ndërmarrësi kanë themeluar Bordin Menaxhues/Komitetin Drejtues (KD) të përbërë nga një përfaqësues nga secili partner i projektit, bordi Drejtues (BD) është takuar të paktën një herë në muaj.

Projekti është financuar 80% nga BE me një vlerë prej 383,517€, ndërsa pjesa tjetër prej 20% nga Komuna e Prishtinës në vlerë 95,879€ apo në total prej 479,397€ me kohë zgjatje për periudhën 2014-2016.

Objektiva e përgjithshme e projektit është të kontribuoj në përmirësimin e kushteve të zhvillimit ekonomik në Kosovë, përmes angazhimit të fermerëve dhe agro-bizneseve me mundësinë e plasimit të produkteve në tregun regjional, si dhe të ndikoj në rritjen e eksportit dhe zëvendësimin e produkteve të importuara me ato vendore. Synimi kryesor ka qenë krijimi i mundësive të reja për punësim sidomos për fermerët e rinj, zvogëlimin e papunësisë, varfërisë dhe migrimit në Kosovë.

Duke iu referuar aktiviteteve në bazë të raportit vjetor të BE-së niveli i arritjeve të objektivave të projektit ka pasur ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik rural në qendrat komunale rajonale dhe një ndikim pozitiv në zëvendësimin e produkteve të importuara në Kosovë.

#### **Realizimi i projektit**

**Objektiva e I-rë** e projektit ka të bëjë me përmirësimin e shërbimeve dhe rritjen e vlerës së produkteve vendore duke themeluar “Tregun Mobil të Fermerëve” që synon promovimin e këtyre produkteve, revitalizimin e ekonomisë rurale duke krijuar mundësi të reja punësimi. Aktivitetet e planifikuara janë krijimi i 9 tregjeve të fermerëve në Prishtinë, dhe angazhimi i 1,200 fermerëve.

Si rezultat janë krijuar 5 tregje mobile të cilat janë funksionale në Prishtinë, dhe 1008 fermerë lokalë kanë përmirësuar në mënyrë direkte dhe indirekte furnizimin dhe promovimin me produkte të freskëta vendore në tregun e fermerëve.

Ndërsa arsytimi sipas implementuesve të projektit për mos krijimin edhe të 4 tregjeve tjera është për shkak të vendeve të papërshtatshme për plasimin e produkteve nga ana e fermerëve. Gjatë planifikimit nga Komuna e Prishtinës nuk janë paraparë vështirësitë siç janë: vendosja dhe zhvendosja e tendave lëvizëse në lokacione të papërshtatshme ku nuk ju mundësohen vend qëndrimet e papërshtatshme për të zhvilluar aktivitetin e tyre. Tregu mobil i fermerëve fillimisht është themeluar në Prishtinë duke ju dhënë e drejta për shitjen dhe promovimin e produkteve të tyre të freskëta vendore 30 fermerëve dhe shoqatave të fermerëve/bizneseve nga 8 komunat e

---

qendrave rajonale (QR). Lloji i tregut mobil të fermerëve është treg me tezga të hapura, objekte këto të cilat kanë siguruar një vend për të ekspozuar produktet vendore.

**Objektiva e II-të** e projektit parasheh revitalizimi i ekonomisë rurale në Prishtinë dhe regionet tjera ka të bëjë me krijimin e vendeve të reja të punës. Aktivitetet e planifikuara janë angazhimi i 1200 fermerëve në tregjet mobile në Prishtinë, 200 fermerë nga QR-të do të rrisin njohuritë mbi menaxhimin e fermës, 20 fermerë që do të trajnohen dhe certifikohen mbi standardet e “Global GAP”.

Sipas raportit vjetor të BE-së projekti ka pasur ndikim në ekonomin rurale, krijimin e vende të reja të punës në një mesatare prej 34%, konkretisht 1008 fermerë lokalë kanë shitur në mënyrë direkte dhe indirekte në tregun mobilë, po ashtu fermerët kanë përmirësuar njohuritë mbi menaxhimin e fermave, promovimin dhe konkurrencën.

Një ndër vështirësitë e projektit ka qenë: inkuadrimi i të gjitha qendrave komunale, tri prej qendrave me përfituese dhe aktive në këtë projekt kanë qenë Podujeva, Prishtina, Lipjani, kurse qendra me jo aktive kanë qenë Fushë Kosova, Obiliqi, Drenas, Graçanicë. Sipas MM, përgjegjësitë e komunës janë koordinimi i aktiviteteve ndër-komunale për implementimin e projektit. Gjithashtu, ndër përgjegjësitë është e paraparë që komuna e Prishtinës të bashkëpunojë me tetë qendrat komunale duke lidhur një memorandum të mirëkuptimit të cilin nuk ka arritur ta realizoj. Edhe përkundër mbajtjes së disa takimeve me qendrat komunale, komuna e Prishtinës nuk ka arritur përfshirjen e të gjitha qendrave sipas projektit të paraparë për shkak se jo të gjitha komunat kanë shprehur interesim për një bashkëpunim të tillë.

**Mungesa e kontrolleve dhe menaxhimit të projektit nga ana e Komunës.** Sipas MM Komuna e Prishtinës është përgjegjëse për menaxhimin dhe vendimmarrjen gjatë implementimit të projektit, kurse dy organizatat tjera janë partner vartës nga komuna. Komuna e Prishtinës si Koordinator e projektit - në bashkëpunim me dy partnerët implementues (GnB dhe Qendra për Ndërmarrësi) ka autorizuar një koordinator/menaxher të projektit nga GnB, duke ia deleguar të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë partnerit implementues të projektit, por kjo nuk e ka përmbushë obligimet e komunës për përcaktimin e një zyrtari institucional për koordinim të projektit dhe llogaridhënie institucionale. Ne kemi konstatuar se të gjitha të dhënat zyrtare lidhur me këtë projekt janë nën posedim të GnB-së dhe komuna nuk posedon ndonjë informat apo dokumentacion mbi realizimin dhe mbarëvajtjen e projektit. Komuna nuk e ka caktuar një menaxher të projektit në kuadër të komunës me qëllim të kontrollit dhe mbarëvajtjes së këtij projektit përmes të cilit do të rritet llogaridhënia dhe transparenca.

### 3.4.1.3 Projekti për strehim dhe integrim për komunitetin Romë, Ashkali, Egjiptianë RAE në lagjen “Ali Ibra” në Gjakovë

Ky projekt është i bazuar në memorandumun e mirëkuptimit të lidhur në shtator të vitit 2009, fillimisht në mes të Caritasit Zvicerran dhe komunës së Gjakovës. Akterët tjerë të bashkëpunuar me vonë për implementimin e këtij projekti janë pajtuar të bashkëpunojnë si bashkë implementues, duke themeluar KD të përbërë nga: Caritasi Zvicerran, Zyra Ndërlidhëse Suedeze në Kosovë, Agjencia Austriake për Zhvillim, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Kthimit të Komuniteteve, Komuna e Gjakovës dhe Komuniteti RAE. Bazuar në memorandumun e nënshkruar, KD i projektit është themeluar me qëllim të garantimit të mbikëqyrjes direkte në vazhdimësi rreth implementimit të projektit.

Objektiva e përgjithshme e projektit është “Përmirësimi i qëndrueshëm i kushteve të jetës për komunitetin RAE “Ali Ibra” në Gjakovë, dhe mbështetja në integrim social, zhvillim të komunitetit, gjenerimin e të ardhurave dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik. Vlera totale e projektit është 3,804,000 € me kohëzgjatje dy vjeçare 2010-2012. Realizimi i këtij projekti ka zgjatur nga viti 2011 deri në 2015.

Pjesëmarrja në bashkëfinancim për realizimin e këtij projekti përveç ndarjes së tokës 3.8 hektarë nga Komuna e Gjakovës, është zotuar se do të kontribuojë edhe në rregullimin e infrastrukturës me një vlerë prej 809,418 €, si dhe financimi nga institucionet tjera vendore si Ministria e Kthimit të Komuniteteve dhe Zyra e Kryeministrit me një vlerë prej afërsisht 550,000 € kurse pjesëmarrja tjetër është bërë nga Caritasi Zvicerran si donatorë kryesorë si dhe donatorët tjerë me një vlerë të përafërt 2,445,000 €.

#### **Realizimi i projektit**

*Objektiva e I-rë* parashihet përmirësimin e kushteve të përhershme të banimit- kostoja për realizimin e kësaj objektive është 2,323,146€. Implementimi ka kaluar nëpër tri faza, Faza e I-rë shtator 2010 – shtator 2011 janë ndërtuar 29 shtëpi, Faza e II-të përfshin periudhën tetor 2011- maj 2013, janë ndërtuar 35 shtëpi dhe Faza e III-të nga qershor 2013-dhjetor 2015, janë ndërtuar 52 shtëpi.

Implementimi i projektit nuk është realizuar sipas MM të nënshkruar në shtator 2009. Komuna e Gjakovës sipas zotimeve në memorandum, gjatë fazës së parë të vitit 2011 ka kryer disa punime sipërfaqësore (rregullimi i gypave kryesor të ujit dhe kanalizimit) në vlerë 88,218€ përderisa për vitet tjera nuk ka ndarë mjetet për realizimin e këtij projekti, e i cili ka pas ngecje gjatë periudhës kohore 2011-2014. Ky projekt nuk është realizuar në afatin e paraparë sipas MM për shkak të mos përmbushjes së zotimeve nga komuna e Gjakovës.

Pas qershorit të vitit 2014, realizimi i projektit është riaktivizuar me ndarjen e mjeteve nga komuna për iniciimin e procedurave të prokurimit për fazën II dhe III për kryerjen e punimeve për rregullimin e infrastrukturës. Edhe përkundër vështirësive buxhetore dhe mungesës së mjeteve financiare projekti ka përfunduar me 31 janar 2015. Komuna është përballur edhe me procedura gjyqësore për mos pagesën e detyrimeve ndaj OE sepse realizimi i këtij projekti nuk është kryer brenda afateve të parapara dhe ka ndikuar në buxhetin e viteve pasuese.



Sipas memorandumit, Caritasi Zvicerran ka qenë në rolin e menaxhimit kualitativ përfshirë ekspertizën e jashtme për planifikim profesional, implementim dhe vlerësim korrekt të projektit. Gjithashtu edhe si anëtar aktiv për vëzhgim dhe monitorim, duke siguruar informata rreth dinamikës së projektit dhe duke u bërë pjesë e diskutimeve dhe zgjidhjes së problemeve që mund të shfaqen gjatë implementimit.

Po ashtu në bazë të memorandumit, KD është përgjegjës për monitorim dhe vlerësim korrekt ndaj gjithë donatorëve të projektit, përgjegjësi kjo e deleguar tek komuna. Ndërtimi i shtëpive nuk është monitoruar në mënyrë efikase dhe si rrjedhojë ndërtimi i shtëpive ka rezultuar si jo funksional pasi që shtëpitë e ndërtuara kanë qenë jo të përshtatshme për banim.

Komuna e Gjakovës ka kontraktuar një kompani private për mbikëqyrjen e ndërtimit të shtëpive derisa nga Caritas u identifikuan mangësi serioze në ndërtim, shfaqja e lagështisë në shtëpitë e ndërtuara, gjë e cila ka shpie deri në demolimin e shtëpive gjatë fazës së dytë, si dhe ndërrimin e operatorit për mos përmbushjen e obligimeve për monitorimin efikas të shtëpive. Përsëritja e tenderit në Fazën 3 është kryer nga ana e Caritasit, ku më pas si organ mbikëqyrës është kontraktuar kompania tjetër për fushat e statikës, energjisë elektrike dhe ujit. Fushat tjera janë monitoruar drejtpërdrejt nga Zyrtari i ndërtimit i emëruar nga "Caritas" dhe janë evituar mangësitë e identifikuar më lartë dhe janë funksionalizuar për banim.

**Objektiva II-të** përfshirja sociale e komunitetit RAE është promovuar përmes aktiviteteve të zhvillimit të komunitetit dhe qasjes në edukim dhe shërbime shëndetësore në nivel komunal. Janë organizuar trajnime profesionale të profileve të ndryshme për të rinjtë dhe gratë e komunitetit RAE. Gjatë këtij projekti janë organizuar takime, trajnime, tryeza të rrumbullakëta dhe punëtori me tema të ndryshme në sektorët e shëndetësisë, edukimit dhe përkrahjes psiko-sociale. Është mbajtur edhe një punëtori planifikuese e përfshirjes sociale e organizuar në tri komponentët e projektit: zhvillimi i komunitetit, integrimi përmes edukimit dhe zhvillimi ekonomik.

**Objektiva III-të** parasheh mundësi të reja të punësimit dhe të ardhura të qëndrueshme. Me implementimin e kësaj pike projekti ka realizuar objektiven e tretë me ndërtimin e kompanisë për riciklim të mbeturinave. Për realizimin e kësaj objekte janë përkrahur nga kompania për menaxhimin e mbeturinave "Çabrati" për sigurimin e qasjes efikase të anëtarëve të komunitetit RAE në deponinë e mbeturinave. Është bërë konsolidimi i këtij biznesi për riciklim të mbeturinave nga komuniteti RAE dhe punësimi afatgjatë i 10 personave si dhe angazhimi i grupit të komunitetit RAE në ndërtimin e shtëpive.


Në përgjithësi realizimi i projektit ka kaluar nëpër disa sfida, mungesa e infrastrukturës në vitin 2011 ka shkaktuar stagnimin e punimeve pas fazës së parë. Faza e dytë ka zgjatur prej vitit 2011 deri në vitin 2013, dhe ndërtimi i infrastrukturës ka filluar vetëm në vitin 2014. Kjo ka nënkuptuar vështirësitë e projektit në aspektin e të qenit efikas. Realizimi i këtij projekti ka përmirësuar kushtet e jetesës së komunitetit RAE, me ndërtimin e 119 shtëpive, punësimin dhe edukimin i këtij komuniteti.

### 3.4.2 Arsimi, shkenca, kultura, sporti dhe zhvillimi rinor

Qeveria e Republikës së Kosovës synon që të ndërtojë një shoqëri të dijes, të integruar në rrjedhat evropiane dhe me mundësi të barabarta për zhvillim personal. Në përputhje me këtë vizion, Qeveria e Republikës së Kosovës angazhohet të ndërtojë një sistem arsimor gjithëpërfshirës, që siguron kushte për formim cilësor dhe në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe shoqërisë. Sektori i arsimit dhe punësimit është një nga tri prioritetet kryesore më të financuara të vendit sipas programit të qeverisë së Kosovës. Sipas raportit të donatorëve pas zhvillimit ekonomik, sundimit të ligjit ky sektorë për vite me radhë ka pranuar numër të konsiderueshëm të fondeve të donacioneve me afro 16 % të totalit të zotimeve dhe disbursimeve të donacioneve.

Më poshtë kemi paraqitur grafikun për financimet nga donatorët sipas prioriteteve qeveritare për sektorin e arsimit.

**Grafiku 5. Shpërndarja e donacioneve në sektorin e arsimit, shkencës, kulturës, sportit dhe zhvillimit rinor krahas donacioneve totale**



\*Vlerësim i auditimit

Burimi: Raportet vjetore të donatorëve MIE, vitet 2014, 2015

Sipas grafikut të paraqitur më lartë shihet se shpërndarja e donacioneve në sektorin e arsimit, shkencë, kulturë dhe rini paraqet një përkrahje prej 16% në vitin 2014, ndërsa ka pas një rënie në 6% në vitin 2015 në raport me donacionet e përgjithshme.

Qeveria e Luksemburgut është një nga donatorët më të mëdhenj në sektorin e arsimit i cili ka ndihmuar në realizimin e projektit "Ndërtimi i qendrave të kompetencës" në nivelin qendror duke ndihmuar në ndërtimin, pajisjen dhe aftësimin e personelit të qendrave të reja të kompetencës në Prizren dhe Ferizaj. Forcimi i aftësimit profesional në Kosovë synon të ndihmojë në zvogëlimin afatgjatë të varfërisë me programe cilësore të aftësimit profesional të lidhura me tregun e punësimit.

Sa i përket investimit të donatorëve në nivelin lokal ne kemi analizuar projektin “Ndërtimi i objektit rekreativ dhe sportiv në shtëpinë e bjeshkatarëve”, projekt ky i financuar nga Komuna e Prizrenit dhe Qeverisë Finlandeze ECNC ( Qendra Evropiane për konservimin natyror).

Më poshtë janë shpalosur informatat për këto dy projekte dhe mangësitë/gjetjet e auditimit si në vijim:

### 3.4.2.1 Marrëveshja e nënshkruar mes Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut

Kjo marrëveshje bashkëfinancuese është nënshkruar në vitin 2013 në mes të qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut dhe qeverisë së Republikës së Kosovës. Implementimi i kësaj marrëveshje ka filluar në vitin 2014-2016 dhe është vazhdimësi e një marrëveshje paraprake të lidhur në vitin 2010-2013. Buxheti për periudhën 2010-2013 ishte gjithsej 9, 200,000€, i përbërë nga kontributi i Luksemburgut: 8,000 000€ dhe kontributi vendor MASHT 1,200 000 €. Ndërsa buxheti shtesë për zgjatjen e projektit 2014-2016 ishte 3,552,500€, i përbërë nga kontributi i Luksemburgut në vlerë 2,000 000€ si dhe kontributi vendor nga MASHT 1,552,500 €.

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është dhënia e kontributit në zhvillimin ekonomik përmes modernizimit të sistemit të arsimit në Kosovë. Numri i lartë i të papunëve kërkon masa aktive për zhvillimin e sektorëve ekonomikë me qëllim të rritjes së punësimit dhe zhvillimit në Kosovë. Roli i Arsimit dhe Aftësisit Profesional (AAP) është që të kontribuojë në zhvillimin e këtyre sektorëve ekonomikë përmes zhvillimit të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave. Objektivi specifik i projektit është që të kontribuojë në reformën e AAP në Kosovë duke i themeluar dy Qendra të Kompetencës profesionale.

Njëra nga këto qendra është në Ferizaj e cila është themeluar me qëllim të zhvillimit të profileve me të reja të sektorit shëndetësor, kurse qendra tjetër e themeluar në Prizren me qëllim të zhvillimit të profileve të tregtisë, ekonomisë dhe turizmit.

#### Realizimi i projektit

**Objektiva e I-rë** rishikimi dhe zhvillimi i kurrikulave dhe materialeve përkatëse të aftësisit dhe didaktike për dy qendrat në përputhje me tregun e punës. Në qendrën e kompetencës në Ferizaj janë miratuar nëntë profile profesionale, prej tyre gjashtë janë funksionale dhe tri ende nuk kanë filluar të implementohen. Gjashtë profilet tanimë ligjërohen në këtë qendër që janë teknik i optikës, teknik për pajisje të dëgjimit dhe të akustikës, ortodontit dhe protetikës, ortopedisë dhe nutricistët. Ndërsa sipas raportit vjetor të zyrës ndërlidhëse të Luksemburgut tri profilet tjerat: mekanik kirurgjik, ndihmës në prodhimin farmaceutik dhe kujdesit shëndetësor për të moshuarit mbetet të shqyrtohet mundësia për të vazhduar për shkak të të dhënave të tregut të punës dhe numrin e vendeve të punës që kërkohen në Kosovë apo në rajon gjatë dekadës së ardhshme, pasi që këto profile janë speciale dhe kërkojnë investim të madh.

Në qendrën e kompetencave në Prizren janë miratuar 13 profile profesionale dhe janë funksionale në tri fusha të profesionale ekonomi, tregti dhe turizëm. Edhe pse projekti do të përkrahë zhvillimin e më shumë profileve se sa që janë paraparë në dokumentin e projektit, ekzistojnë module të përbashkëta bazike për profilet e ekonomisë dhe tregtisë.

**Objektiva II-të** ndërtimi, furnizimi me pajisje dhe funksionalizimin i dy qendrave në Ferizaj dhe Prizren. Në projekt propozim është paraparë që këto dy qendra të zhvillohen përmes sistemit të moduleve me një kapacitet prej 800 nxënësve. Këto objekte janë funksionale dhe janë ndërtuar dhe furnizuar sipas planifikimit dhe natyrës së profileve të veçanta.

Ky projekt ka paraparë që më pas të vlerësohet ndikimi për të parë dhe inkuadrimitin e nxënësve të këtyre profileve profesionale pas përfundimit të shkollimit. Sipas këtij projekti ky modul parashihet që të zhvillohet në të ardhmen në mënyrë që të matet ndikimi. Përmes këtij projekti të vlerësimit do të mbështetet zbatimi i një sistemi të ri të menaxhimit të dhënave i cili është i lidhur me "Kornizën e përbashkët të sigurimit të cilësisë për AAP". Ky projekt parashihet të realizohet përmes mbledhjes së të dhënave nga burimet dytësore të dhënave (MASHT, Shkollat e AAP-së, MSH dhe MPMS). Pasi që gjenerata e parë sapo ka përfunduar kualifikimin arsimor në këto dy qendra, ku këto të dhëna për momentin mungojnë.

Sipas zyrtarëve të MASHT, është sfiduese qëndrueshmëria e këtyre qendrave dhe sistemin e ri të qendrave në Kosovë për shkak të kostove të larta të furnizimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve në të ardhmen. Donatorët kanë konfirmuar se do të bëjnë përpjekje që të sigurojnë që MASHT dhe palët e tjera kyçe të marrin pronësi të veprimtarive dhe rezultateve të projekteve. Bazuar në këtë do të jetë sfidë në të ardhmen ngritja e kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë së këtyre qendrave. Përmes projektit do të inkurajohen marrëdhënie të afërta të punës mes divizionit të AAP-së në MASHT, MPMS-së, MSH-së dhe punëdhënësve.

### 3.4.2.2 Marrëveshja e nënshkruar mes Komunës së Prizrenit dhe Qeverisë Finlandeze ECNC ( Qendra Evropiane për konservimin natyror)

Ky projekt është i bazuar në memorandumit të lidhur në fund të vitit 2013, ndërsa implementimi i këtij projekti është bërë në vitin 2014 siç ka qenë e paraparë në planin kohor. Ky projekt është zhvilluar në kuadër të rrjetit për Ballkanin Perëndimorë, rrjeti i veprimit të planifikuar për Bio diversitetin lokal, me synim të përmirësimit dhe mbrojtjes së natyrës. Vlera totale e projektit është 25,000€, participimi nga donatori ECNC ishte 20,000€ dhe nga Komuna 5,000€.

Gjatë vitit 2011-2013 Komuna e Prizrenit ishte pjesëmarrëse aktive në hartimin e Planit Lokal të Veprimit për Biodiversitet, të udhëhequr nga Qendra Evropiane për Konservim të Natyrës (ECNC), në bashkëpunim me Qendrën Rajonale të Mjedisit (REC).

Ky plan është aprovuar në vitin 2013, dhe ka filluar implementimi i tij me përzgjedhjen e këtij projekti. Sipas MM komisioni për vlerësim të projekteve duhet të vlerësojë se ky projekt ka ndikim më të madhe në ruajtjen e Biodiversitetit në atë lokacion si dhe të bëjë vlerësoj suksesin e projektit në baza periodike.

Objektiva e përgjithshme e projektit është investimi në emër të mbrojtjes së Bio Diversitetit, ndërsa sa i përket objektivës specifike të projektit në regjionin e Prizrenit është “Ndërtimi i objektit rekreativ dhe sportiv në shtëpinë e bjeshkatarëve” afër fshatit Struzhë.

### **Realizimi i projektit**


Komuna e Prizrenit ka shfrytëzuar fondin e këtij projekti për ndërtimin e një qendre rekreative çlodhëse në bazë të MM dhe planit lokal për biodiversitetin. Qëllimi i përgjithshëm i kësaj objektivës është arritur, mirëpo nga vizita në terren dhe sipas zyrtarëve përgjegjës kemi konstatuar se për ndërtimin e kësaj qendre sportive nuk ka raport nga ana e komisionit për vlerësimin e projekteve, si dhe nuk ka dëshmi mbi indikatorët e suksesit për rritjen e numrit të pushuesve për 30 % që është paraparë në planin e veprimit lokal për biodiversitetin. Po ashtu komuna e Prizrenit nuk ka promovuar tek palët e interesit shfrytëzimin e kësaj qendre rekreative. Projekti si i tillë e ka arritur qëllimin për objektiven e përgjithshme për çka është destinuar mirëpo nuk e ka arritur që ta bëjë të shfrytëzueshme këtë qendër.

#### **3.4.3 Shëndetësia moderne**

Kjo shtyllë parasheh vazhdimin e përmirësimit të gjendjes shëndetësore të popullatës si një ndër prioritetet e qeverisë duke synuar ndërtimin e një sistemi shëndetësor efikas, të mbështetur në resurse të qëndrueshme njerëzore dhe me një financim adekuat të qëndrueshëm, që siguron qasje të barabartë në shërbime cilësore dhe kosto-efektive shëndetësore për të gjithë qytetarët.

Spektori i shëndetësisë është një nga prioritetet e qeverisë të cilat nuk janë financuar mjaftueshëm nga donatorët. Sipas raportit vjetor të donatorëve të vitit 2014 dhe 2015 kujdesi shëndetësor modern ka pranuar shumë pak përkrahje nga donatorët e jashtëm, jo më shumë se 3% të fondeve të përgjithshme.

Më poshtë kemi paraqitur grafikun për financimet nga donatorët sipas prioritetëve qeveritare për sektorin e shëndetësisë.

**Grafiku 6. Shpërndarja e donacioneve në sektorin e kujdesit shëndetësor modern krahas donacioneve totale**

\*Vlerësim i auditimit

Burimi: Raportet vjetore të donatorëve MIE, vitet 2014, 2015

Sipas grafikut të paraqitur më lartë shihet se shpërndarja e donacioneve në sektorin e shëndetësisë paraqet një përkrahje prej 2% në vitin 2014, ndërsa ka pas një rritje të ultë prej 3% në vitin 2015 në raport me donacionet e përgjithshme.

Sektori i shëndetësisë ka pranuar kontribute të pakta nga donatorët, një ndër donatorët me një kontribut më të madhë është Qeveria e Luksemburgut në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, përfitues i së cilës është MSH, që janë duke realizuar projektin “avancimi i qeverisjes në zhvillimin e politikave, në rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore” si dhe realizimi i projektit në nivel lokal për kujdesin shtëpiak “Home Care” i cili fokusohet në ofrimin e shërbimeve shëndetësore përmes mbështetjes së të moshuarve që janë të lënë pas dore.

Më poshtë janë shpalosur informatat për realizimin e këtyre dy projekte dhe mangësitë / gjetjet e auditimit si në vijim:

### 3.4.3.1 Marrëveshja e nënshkruar mes Qeverisë së Kosovës/Ministritë së Shëndetësisë dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut

Kjo marrëveshje bashkëfiancuese është nënshkruar në vitin 2013 në mes të Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut dhe Qeverisë së Kosovës. Kjo marrëveshje është aprovuar nga Kuvendi në fund të vitit 2015 ndërsa implementimi i këtij projekti është paraparë që të bëhet për vitet 2016-2019. Vlera totale e kontratës është 9,600,000€ ku kontributi i Luksemburgut është 6,000,000€ dhe nga MSH 3,600,000€.

---

Pas marrëveshjes bilaterale të lidhur midis dy shteteve u nënshkrua edhe MM ku është paraparë objektiva e përgjithshme e programit përkrahës për shëndetësi e që është avancimi i qeverisjes së shtetit duke u fokusuar në zhvillimin e politikave të cilat do të rrisin cilësinë e shërbimeve shëndetësore në institucionet shëndetësore publike dhe private sa më afër standardeve ndërkombëtare. Objektivat specifike të këtij projekti synojnë përmirësimin e kapaciteteve të planifikimit, udhëheqjes dhe menaxhimit të akterëve shëndetësorë.

Ministria e shëndetësisë gjatë fazës sa ne ishim në auditim edhe përkundër angazhimit tonë dhe kërkesave të vazhdueshme për ofrimin e dokumentacionit mbështetës për realizimin e projektit për marrëveshjen e nënshkruar me qeverinë e Luksemburgut nuk na kanë ofruar.

Pas dërgimit të draft raportit në entitetet e audituara, MSH ka sjellë dokumentacionin mbështetës për të gjeturat e identifikuara në draft raport, të cilat i kemi analizuar dhe do ti paraqesim në brendi të raportit.

### **Realizimi i projektit**

**Objektiva I-rë** fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe organizatave të hisedarëve shëndetësorë në përmbushjen e roleve dhe përgjegjësi të tyre të reja.

Lidhur me këtë objektivë projekti aktualisht është duke vazhduar punën në mbështetjen e zbatimit të reformës së sektorit shëndetësor përmes fuqizimit të kapaciteteve të akterëve shëndetësorë për shkathtësi më të mira të planifikimit, udhëheqjes dhe menaxhimit.

Sipas raportit vjetor të përgatitur nga zyra ndërlidhëse e Luksemburgut për vitin 2016 realizimi i aktiviteteve të projektit përqendrohet në MSH, në dy spitale rajonale (në Gjilan dhe Prizren) që janë njësi përbërëse të shërbimeve spitalore dhe universitare klinike të Kosovës, odën e mjekëve dhe qendrën për zhvillimin e mjekësisë familjare në Kosovë.

Sipas këtij raportit i cili është ofruar si dëshmi e vetme lidhur me aktivitetet e projektit, janë shënuar një numër aktivitete; trajnimin për monitorim dhe vlerësim (M&V) të 50 zyrtarëve nga MSH dhe institucionet e tjera shëndetësore, ri akreditimin tre-vjeçar të programit të specializimit në mjekësi familjare, nënshkrimin e memorandumit të ri të mirëkuptimit ndërmjet MSH-së dhe Kolegjit mbretëror të mjekëve të përgjithshëm për gjashtë vitet e ardhshme, si dhe ofrimin e asistencës teknike për odën e mjekëve të Kosovës, në kuadër të përpjekjeve për zhvillimin e kapaciteteve.

Sidoqoftë të gjitha këto aktivitete nuk kanë mundur të dëshmojnë me dokumentacionin mbështetës gjatë periudhës së auditimit. Në bazë të dokumenteve të ofruara kemi identifikuar se janë realizuar aktivitetet mbi trajnimin e 50 zyrtarëve nga MSH-ja dhe institucionet e tjera shëndetësore për monitorim dhe vlerësim (M&V), realizimi i këtij aktiviteti përmban listën e personave të trajnuar rezultatet e provimeve, programin e trajnimeve si dhe materialet e prezantuara për këtë fushe.

Po ashtu, gjatë vitit 2016 është bërë riakreditimi tre-vjeçar i programit të specializimit në mjekësi familjare, nënshkrimi i memorandumit të ri të mirëkuptimit ndërmjet MSH-së dhe Kolegjit Mbretëror të Mjekëve të Përgjithshëm (RCGP) për gjashtë vitet e ardhshme, si dhe ofrimin e asistencës teknike për Odën e Mjekëve të Kosovës. Ky raport thekson rezultatet e projektit e që janë

zhvillimi i një sistemi të Monitorimit dhe Vlerësimi (M&V), i cili është harmonizuar me kornizën logjike të Strategjisë Sektoriale Shëndetësore. Një tjetër rezultat në këtë raport përmendet doracak i projektit i aprovuar në dhjetor të vitit 2017, i cili i përfshin të 16 Kartelat Identifikuese të Indikatorëve, një matricë të M&V dhe Matricën e Menaxhimit të Vlerësimi të Rrezikut.

Nga materialet që ne kemi pranuar është vërtetuar se në kuadër të kësaj objekte është publikuar, “Plani i veprimit të strategjisë sektoriale të shëndetësisë 2017-2021” dhe “Analiza e situatës në shërbimin spitalor klinik dhe universitar të Kosovës”.

**Objektiva II-të** përmirësimi i performancës dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore në sektorin publik

Marrë parasysh raportin vjetor të përgatitur nga zyra lokale e Luksemburgut, objektivat dhe rezultatet e projektit mbetën në masë të madhe të pandryshuara, mirëpo u sugjeruan ndryshime në kornizën logjike me qëllim të harmonizimit më të madh të detyrave dhe aktiviteteve me ato të planit të veprimit të strategjisë sektoriale shëndetësore 2016-2020 të MSH-së.

Po ashtu, gjatë vitit 2016 janë realizuar aktivitete drejt përmirësimit të performancës dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore që ndërlidhet me riakreditimi ndërmjet MSH-së dhe Kolegjit Mbretëror të Mjekëve të Përgjithshëm (RCGP).

Akreditimi i përsëritur i programit të specializimit në mjekësi familjare si dhe MM i ri ndërmjet RCGP-së dhe MSH-së, ofrojnë një bazë të fortë për zhvillime të mëtejme në kujdesin parësor shëndetësor në vitet e ardhshme.

Në dokumentin e marrëveshjes së memorandum mirëkuptimit janë të parapara realizimi i disa aktiviteteve dhe ka pasur një progres të vogël në zhvillimin e programit të trajnimit të mjekësisë familjare në Kosovë për arsye se mjekët nuk mund të trajnohen në mënyrë të vazhdueshme për shkak të anagazhimeve të tyre dhe kostove që bartin këto trajnime.

**Objektiva III-** të parashih përdorimin e suksesshëm të Sistemit Informativ Shëndetësorë (SISH) të integruar, i instaluar dhe funksional në të gjitha institucionet shëndetësore publike <sup>16</sup>

Gjatë auditimit të këtij projekti nga Ministria na është ofruar vetëm raporti vjetor i Luksemburgut për vitin 2016 për realizimin e objektivave të parapara në marrëveshje.

Marrë parasysh se të gjitha këto aktivitete është dashur të mbështeten në periudhën e ekzekutimit të auditimit me dokumentacionin relevantë, konsiderojmë se MSH nuk ka bashkëpunuar në nivel të duhur. Po ashtu nuk janë ofruar informata të tjera mbi shfrytëzimin e buxhetit dhe shpenzimet e realizuara për këto aktivitete.

---

<sup>16</sup> Kjo objektive do të trajtohet me një auditim të veçant



### 3.4.3.2 Marrëveshja e nënshkruar mes Komunës së Fushë Kosovës dhe “Caritas” Kosova

Marrëveshja e bashkëpunimit mes Caritas Kosova dhe Komunës së Fushë Kosovës është nënshkruar në shkurt 2016, për projektin “ Ngritja e përkujdesit social, shtëpiak dhe ambulatorë” në Fushë Kosovë. Buxheti i shpenzuar për këtë projekt është 242,848€, kontributi i komunës së Fushë Kosovës ishte 222,818€ ndërsa nga Caritas Kosova 20,030€. Neve nuk na është dokumentuar apo dhënë ndonjë arsyetim se pse përqindja më e lartë e financimit është nga komuna. Projekti është paraparë të kryhet për periudhë 11 mujore. Kjo marrëveshje është realizuar në fund të vitit 2016. Objektiva e përgjithshme e programit të përkujdesit shtëpiak “Home Care” fokusohet në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shtëpiak përmes mbështetjes së të moshuarve që janë të lënë pas dore, të braktisur dhe të paaftë.

#### Realizimi i projektit

Përkundër objektives së përgjithshme të programit të përkujdesit shtëpiak “Home Care”, Komuna e Fushë Kosovës ka implementuar objektivat specifike të përcaktuara nga vet ajo përmes memorandumit të cilat në masë të vogël janë brenda objektivave të projektit dhe marrëveshjes bazë për projektin “Ngritja e përkujdesit social, shtëpiak dhe ambulatorë”. Objektivat e planifikuara në marrëveshjen e nënshkruar kanë qenë:

**Objektiva I-rë** shërbimet sociale, edukative dhe shëndetësore, për përmirësimin e kushteve të veprimtarisë për shtresat sociale;

**Objektiva II-të** vazhdimin e përkrahjes financiare të punësimit të qytetarëve të komunës, punëtorë në veprimtari të ndryshme sociale dhe edukative

**Objektiva III-të** parandalimi i procesit të migrimit ilegal nëpërmjet krijimit të vendeve të punës

**Objektiva IV-të** përkujdesje sociale dhe shëndetësore për familjet e komuniteteve RAE.

Objektivat e përcaktuar nga Komuna e Fushë Kosovës kanë devijuar krahas objektivave të programit “Home Care” dhe të marrëveshjes në përgjithësi. Komuna është dashur të përmbushë objektiven kryesore të programit “Home Care” e që është ofrimi i shërbimeve të përkujdesit shtëpiak përmes mbështetjes së të moshuarve që janë të lënë pas dore.

#### Devijimi nga rezultatet dhe objektivat e projektit

Gjatë implementimit të këtij projekti janë përfshirë edhe objektiva për sektor tjerë në kuadër të cilëve janë punësuar 75 persona në veprimtari dhe profile të ndryshme si në: Administratë Komunale Publike janë punësuar 47 punëtorë (pastrues, rojtar sigurie, administratorë, kuzhinier, vozitës, dhe bashkëpunëtor), në shëndetësi janë punësuar 19 punëtorë, si dhe në arsim janë 9 të punësuar tjerë. Pasi që projekti sipas programit të Caritasit “Home Care”, parasheh krijimin e ekipeve mobile për kujdesin ndaj pacienteve të palëvizshëm, nga 75 të punësuar në kuadër të këtij projekti vetëm 19 të punësuar janë në sektorin e shëndetësisë për çka edhe është dedikuar projekti e që konsiderojmë se nuk është arritur qëllimi i realizimit të këtij projekti. Të punësuarit në sektorin e shëndetësisë

---

kryesisht kanë dhënë kontribut tek njerëzit me aftësi të kufizuara dhe njerëzit e moshuar dhe të lënë pas dore.

Caritas Kosova ka raportuar për të punësuarit në shëndetësi në baza 3 mujore për aktivitet e kryera kur edhe janë bërë pagesat perkatëse, ndërsa për punonjësit tjerë ka raportuar duke përshkruar titullin e punëve të kryera por pa ofruar detaje lidhur me aktivitetet e kryera. Kontratat për këto shërbime janë nënshkruar nga ana e Caritas Kosova me punonjësit në baza vjetore. Mungesa e raportimit zbeh llogaridhënin dhe transparencën sa i përket aktiviteteve që ndërlihen me ndihmën nga jashtë.

### **Mungesa e transparencës në proces dhe transferi i mjeteve financiare tek donatori**

Komuna e Fushë Kosovës ka lidhur marrëveshje me Caritas Kosova duke anashkaluar procesin e transparencës dhe procedurave të hapura për shpallje publike. Po ashtu nuk ka planifikuar buxhetin për implementimin e projektit, andaj për realizimin e këtij projekti ka marrë aprovimin drejtëpërdrejt nga Kuvendi Komunal. Në mungesë të mjeteve Kuvendi Komunal ka lëshuar vendimin për bashkëpunim me Caritas Kosova, organizatë jo qeveritare (OJQ). Ky vendim është bazuar në kërkesën paraprake të "Caritas" Kosova për vazhdimin e bashkëpunimit të përbashkët me komunën për vite me radhë .

Për pagesat e kryera sipas marrëveshjes komuna ka transferuar në llogari të Caritas-it mjetet në vlerë prej 222,818 € për pagesat e pagave të punëtorëve, pasi që kontratat janë të lidhura në mes të Caritas Kosova dhe punonjësve. Edhe pse më shumë se 90% e këtij projekti është financuar nga Komuna e Fushë Kosovës bartja e mjeteve është bërë tek donatori duke mos paraparë rreziqet e keq menaxhimit dhe dështimi në realizimin e projektit nga donatori. Komuna ka transferuar mjetet tek donatori gjatë katër fazave apo në çdo tre mujor siç ishte e paraparë me marrëveshje. Kjo praktikë e transferimit të mjeteve tek donatori është praktikuar për vite me radhë. Caritas Kosova në raportet e bashkëpunimit nuk ka raportuar për të gjithë punonjësit, transferi nga komuna është bërë pa u siguruar se shërbimet janë kryer në kohë dhe se janë duke u shpenzuar për çka janë destinuar.

---

## 4 Konkluzionet

### **Konkluzionet për procedurat e koordinimit të ndihmës së jashtme në Kosovë ,vendosjes së prioriteteve, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin**

- Në legjislacionin aktual nuk është e përcaktuar përgjegjësia e institucioneve relevante për administrimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave. Institucionet qeveritare nuk kanë një bazë të të dhënave të përgjithshme për marrëveshjet e ratifikuara në Kuvend dhe Presidencë për të pasqyruar numrin e marrëveshjeve të nënshkruara në numër dhe vlerë financiare. Si pasojë e mungesës së kësaj baze të të dhënave në nivel të vendit nuk ka informata të plota dhe të sakta për marrëveshjet e realizuara, ato në proces të realizimit dhe marrëveshjet e tjera të cilat janë nënshkruar por për arsye të ndryshme realizimi i tyre nuk ka filluar ende.
- Koordinimi i institucioneve për marrëveshjet ndërkombëtare nuk ka arrit që të jetë funksional në mënyrë që raportimi dhe regjistrimi i ndihmës së huaj të jep efektet e duhura. Disa nga projektet të financuara nga donatorët nuk janë në harmoni me programet qeveritare sipas sektorëve të caktuar. MIE nuk ka arritur të ofrojë këshillime dhe modele praktike për ministritë tjera lidhur me hartimin e projekteve apo metodologji të përgatitjes dhe dorëzimit të projekteve;
- Grupet punuese për përcaktimin e prioriteteve nuk kanë qenë plotësisht funksionale, duke mos mbajtur takime të rregullta vjetore ato janë takuar vetëm një here përgjatë tri viteve. Mungesa e këtyre takimeve ka pasur për pasojë mos hartimin dhe prezantimin e planeve vjetore dhe prioriteteve strategjike të shtetit. DAZH në cilësinë e sekretariatit nuk ka hartuar rregullore mbi mënyrën e organizimit dhe funksionit të këtyre grupeve punuese;
- Sistemi i integruar i monitorimit, vlerësimit dhe raportimit nuk është ende funksional. Përcaktimi indikatorëve kryesor për monitorim nuk është propozuar nga grupet punuese me qëllim të matjes së progresit për zbatimin e ndihmës së donatorëve në harmoni me prioritet e qeverisë;
- Raportimi mbi aktivitetet e donatorëve nuk paraqet një gjendje të plotë dhe të qartë mbi bashkëfinancimet e bëra. MIE përgatit raportin vjetor bazuar në Platformën për Menaxhimin e Ndihmës ku nuk raportojnë të gjithë donatorët. Ky raportim paraqet një gjendje përshkruese të financimeve nga donacionet dhe shpërndarjen e tyre sektoriale si dhe të financimit të pranuar nga komunat e përfshira; dhe

---

## Konkluzionet për menaxhimin dhe realizimin e projekteve nga ana e përfituesve

- Institucionet përfituese i kanë menaxhuar projektet e tyre në përputhje me qëllimin për çka janë destinuar. Realizimi i projekteve është bërë sipas kërkesave të parapara për këto projekte, gjë që ka ndikuar në plotësimin e nevojave si dhe përmirësimin e infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit, ngritjes së cilësisë së arsimit dhe zhvillimit të tregut duke ndikuar në zvogëlimin e papunësisë.
- Megjithatë, mbetet shqetësues fakti që, dy projektet e Kompanive të ujërave “Hidro regjioni” në Prizren dhe “Hidromorava” në Gjilan nuk janë duke u implementuar sipas afatit të paraparë përfundimin e punimeve. Implementimi i projekteve për këto dy kompani është në nivel të ulët të realizimit edhe përkundër faktit që afati kohorë për realizimin e projektit ka kaluar. Kompania e ujërave “Hidroregjioni jugor ” në Prizren nuk ka arrit të realizojnë objektivat e tyre për marrëveshjen me qytetarët për ndërtimin e impianteve të ujërave, sensibilizimin e banorëve të regjionit të Prizrenit për kyçje në rrjetin e ujësjellësit. Po ashtu edhe kompania e ujërave “Hidromorava” në Gjilan ka hasur në vështirësi të implementimit të projektit në aspektin e pronësisë, kyçjes energjetike si dhe çështje të përkatësisë etnike.
- KRU “Hidroregjioni jugor ” për mos realizimi i punimeve ka hasur në vështirësi për shkak të mos përzgjedhjes së operatorit ekonomik të duhur i cili ishte përzgjedhur njëanshëm nga ana e CDI-së. Si pasojë, projekti nuk është realizuar sipas planit dinamik, OE nuk ka arritur që ti kryej punimet ashtu siç është paraparë, me c’rast është ndërprerë kontrata, dhe ka krijuar vonesa në realizimin e projektit;
- KRU “Hidromorava” në Gjilan nuk ka arrit të përgatit raporte periodike që ofrojnë informata të sakta, relevante dhe në kohë lidhur me progresin drejt arritjes së planit të paraparë, në mënyrë që të rrisë llogaridhënien për burimet e përdorura dhe për rezultatet e arritura. Kompania “Hidromorava” si organ mbikëqyrës ka kontraktuar një kompani private për monitorimin e projektit mbi rrjedhën dhe ecurinë e punimeve. Këto raporte më tepër janë raporte përshkruese të gjendjes por nuk ka bërë ndonjë raport përmbledhës duke paraqitur të arriturat kundrejt planit dinamik të paraparë;
- Komuna e Prishtinës ka arritur të realizojë po thuajse të gjitha objektivat e përcaktuara me përjashtim të mos funksionalizimit të katër tregjeve tjera për shkak të lokacioneve të papërshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve afariste. Komuna nuk ka lidhur marrëveshje me qendrat tjera rajonale siç është paraparë në MM për arritjen e një bashkëpunimi më të mirë për implementimin e projektit në plotësi për shkak të mos bashkëpunimit në mes të qendrave tjera rajonale. Po ashtu nuk ka vendosur mekanizma të vetë të kontrollit dhe raportimit për menaxhimin e projektit për këtë ka autorizuar një partner implementues të projektit që ti udhëheq të gjitha procedurat e projektit;
- Komuna e Prizrenit ka arritur që të realizoj objektiven e përgjithshme të projektit për ndërtimin e qendrës rekreative mirëpo nuk ka promovuar këtë qendër dhe si pasojë ajo nuk është e shfrytëzueshme nga qytetarët;

- MSH nuk ka bashkëpunuar në mënyrë të duhur gjatë periudhës së auditimit për të analizuar nëse ishin arritur objektivat e parashtruara. Pas dërgimit të draft raportit të auditimit kjo ministri ka ofruar dëshmi shtesë mbi kryerjen e disa aktiviteteve edhe pse nuk ishin të plota. Bazuar në këtë ne kemi vlerësuar se gjendja sipas këtyre të dhënave paraqet një realizim të pjesërishtë të aktiviteteve kundrejt objektivave. Mungesa e dokumenteve të plota, mbështese dhe relevante në peridhën e ekzekutimit të auditimit e zbeh llogaridhënien dhe transparencën sa i përket aktiviteteve të kryera për ndihmat nga asistenca e jashtme; dhe
- Komuna e Fushë Kosovës ka devijuar nga rezultatet dhe objektivat e projektit. Përveç kësaj Komuna e Fushë Kosovës nuk ka qenë transparente për procedura të hapura dhe shpallje publike. Po ashtu bartja e mjeteve është bërë tek donatori çdo tremujor si parapagim edhe pse pjesa dërmuese e financimit ka qenë nga komuna, gjë e cila rritë rrezikun për keq menaxhimin e parasë publike;

## 5 Rekomandimet

### Rekomandimet për procedurat e koordinimit të ndihmës së jashtme në Kosovë ,vendosjes së prioriteteve, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin

Rekomandojmë Kuvendin e Kosovës që përmes Qeverisë së Kosovës:

- Të ndaj përgjegjësit dhe të definojë qartë institucionet përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe administrimin e bazës së të dhënave për marrëveshjet e bashkëfinancimit, në mënyrë që të kemi një raportim në nivel shtetëror mbi gjendjen e përgjithshme të marrëveshjeve të bashkëfinancimit dhe marrëveshjeve tjera financiare.

Rekomandojmë MIE që:

- Në cilësinë e sekretariatit duhet të sigurojë koordinimin e institucioneve për marrëveshjet ndërkombëtare në mënyrë që të gjitha projektet të financuara nga donatorët të jenë në harmoni me programet qeveritare sipas sektorëve të caktuar;
- Të përgatitë modele praktike në mënyrë që të shërbejë si udhëzues për të gjitha ministrin për përgatitjen e projekt propozimeve për financim. Këto modele do të sigurojnë se projektet e financuara nga donatorët janë identifikuar dhe rishikuar përmes akterëve përgjegjës në mënyrë që të jenë në harmoni me prioritetet qeveritare dhe mos dyfishimit të tyre;
- Të hartoj dhe nxjerr rregullore mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të grupeve punuese, të organizoj takime të rregullta, të përgatit raportet dhe prezantimet për prioritetet e Republikës së Kosovës;
- Të sigurojë koordinimin e një Sistemi të Integruar të Monitorimit në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha ministrin duke demonstruar realizimin e aktiviteteve në përputhje me objektivat e përcaktuara dhe zotimet e bëra nga të dy palët. Një raport i tillë do të sigurojë Qeverisë që këto ndihma të jenë në harmoni të plotë me prioritetet zhvillimore, si dhe të jenë të ndërlidhura sa më shumë që është e mundur me dokumentet strategjike në mënyrë që të arrihet efektivitet më i lartë i këtyre ndihmave;
- Të shqyrtojnë mundësitë e zhvillimit të metodave të avancuara të raportimit duke i përmbush kriteret e plotësisë, saktësisë dhe koherencës për pasqyrimin e gjendjes së donacioneve si dhe paraqitjen e rezultateve të arritura kundrejt objektivave të parapara; dhe

---

## Rekomandimet për menaxhimin dhe realizimin e projekteve nga ana e përfituesve

Rekomandojmë Ministritë/Komunat si përfituese dhe implementues të projekteve me bashkëfinancim nga donatorët e jashtëm që:

- Implementuesit e projekteve të KRU “Hidroregjioni jugor” në Prizren dhe KRU “Hidromorava” në Gjilan në bashkëpunim me Komunën të realizojnë objektivat e tyre për marrëveshjen me qytetarët për ndërtimin e impianteve të ujërave, sensibilizimin e banorëve për kyçje në rrjetin e ujësjellësit;
- KRU “Hidroregjioni jugor ” në Prizren të bashkëpunojnë dhe koordinojnë aktivitetet e tyre për udhëheqjen e procedurave të prokurimit me partnerin implementues CDI
- KRU “Hidromorava” në Gjilan të dizajnojë dhe të vendosë një sistem përmes së cilit do të prodhojë raporte periodike që ofrojnë informata të sakta, relevante dhe në kohë lidhur me progresin drejt arritjes së planit të paraparë, në mënyrë që të rrisë llogaridhënien për burimet e përdorura dhe për rezultatet e arritura.
- Komuna e Prishtinës si pronare e projektit dhe si bashkëfinancues të sigurojë se me rastin e bashkëfinancimeve në të ardhmen të koordinoj aktivitetet e tyre me komunat e tjera qëllim të realizimit të projektit në tërësi. Po ashtu në të ardhmen gjatë implementimit të projekteve të caktojë menaxherin e projektit në mënyrë që të rrisë transparencën mbi procesin e realizimit, mbikëqyrjes dhe monitorimin e projekteve.
- Komunën e Prizrenit si implementues për projektet të sigurojë se janë duke u realizuar projektet krahas të gjitha objektivave të përcaktuara të programeve zhvillimore të donatorit dhe ti promovojë ato në mënyrë që të arrihen rezultate;
- Ministri i shëndetësisë në të ardhmen duhet të sigurojë bashkëpunim në nivel të duhur me zyrtarët e ZKA-se, si dhe të rishikoj proceset e arkivimit, ruajtjes dhe sistemimit të dokumenteve dhe t’i identifikoj arsyet e mos ofrimit të informatave të plota për auditimin, njëkohësisht të përforcoj mekanizmat e kontrollit dhe llogaridhënies me qëllim që këto situata të mos përsëriten në të ardhmen. Si dhe të sigurojë se objektivat e përcaktuara në marrëveshje për realizimin e projektit do të kryehen me kohë; dhe
- Komuna e Fushë Kosovës në të ardhmen të sigurojë implementimin e projekteve bazuar në objektivat e programit. Kontratat të nënshkruhen bazuar në procedura të hapura dhe transparente. Si dhe praktikat e deritanishme të bartjes së mjeteve për realizimin e projekteve me donatorët të ndërpriten duke ju shmangur keq përdorimeve të mundshme.

---

## Shtojca 1. Të ardhurat e Qeverisë dhe të ndihmës së huaj

Viti	2014	2015	2016
Buxheti i Republikës së Kosovës	1.486	1.576	1.588
Donacionet	212	208	197
Përqindja e donacioneve në raport me Buxhetin e Republikës së Kosovës	14%	13%	12%



## Shtojca 2. Të ardhurat nga donatorët për vitin 2016

Viti 2016		
SEKTORET SIPAS OECD	TE DISBURSUARA	TE ZOTUARA
Qeveria dhe shoqëria civile	57,703,838	46,671,704
Uji dhe sanitaria	24,094,919	9,855,509
Banka dhe financa	18,634,290	32,992,362
Gjenerimi I energjise dhe furnizimet	18,581,161	7,491,075
Edukimi	17,601,700	8,953,231
Te pergjithshme / ndersektoriale	17,227,159	21,473,843
Kommunikim	12,862,741	12,695,273
Biznes dhe sherbime tjera	11,218,914	11,884,316
Infrastruktura sociale dhe sherbime	10,360,443	8,269,615
Agrokultura	9,930,203	11,698,937
Shendetesia	3,722,469	2,370,688
Te paalokuara/ Te pa specifikuara	2,955,379	353,434
Politika tregtare dhe rregulloret lidhur me tregtine	2,870,606	3,256,539
Industri	2,638,270	2,794,101
Ndihma humanitare	1,390,590	490,090
Pylltari	1,037,401	1,037,401
Mbeshtetje per OJQ	389,131	368,128
Shpenzime administrative per donatore	212,780	150,000
Politikat e popullacionit / Programet e shendetit riprodhu	208,090	302,193
Transporti dhe deponimet	87,545	518,600
Ndihma akomoduese dhe Programi i pergjithshem asistue	76,677	-
Turizmi	20,243	60,535
<b>Totali</b>	<b>213,824,549</b>	<b>183,687,574</b>

### Shtojca 3. Niveli qendror-projektet me bashkëfinancim nga donatorët

Projektet e financuara 2014-2016 - Niveli qendror				
Partneret qeveritar	Institucionet perfituese	Projekti	Financimi	
			Donatori	Përfituesi
Marreveshja e Dukates se Madhe te Luxemburgut - Qeveria e Kosoves	MSH dhe MASHT	Programi përkrahës për arsim dhe shendetesi në Kosovë (KSV/017)	6,000,000.00	3,600,000.00
Marreveshja e CDI- Qeveria e Kosoves	NP "Hidromorava" NP "Hidroregjioni"	Programit mbështetës për Ujë dhe Kanalizim në Zonat Rurale faza e V-të	11,814,340.17	7,945,604.62
<b>Totali: €uro</b>			<b>17,814,340.17</b>	<b>11,545,604.62</b>

## Shtojca 4. Niveli lokal-projektet me bashkëfinancim nga donatorët

Projektet e financuara Komunë-Donatorë 2014-2016				
Partnerët bashkëfinancues		Projekti	FINANCAT	
Komunat	Donatori		Donatori	Komuna
Prishtina	BE - KP	Themelimi i tregut mobil të fermerëve në Prishtinë	383,517.00	95,879.00
Prizreni	Qeveria Finlandeze	Ndërtimi i Qendrës Sportive Rekreative	19,930.00	5,191.00
Gjakova	Caritas, Zyra Suede	Projekti për strehim dhe integrim të komunitetit RAE, Lagjja "Ali Ibra"	2,798,386.00	1,362,630.00
Fushe Kosova	Caritas Kosova - KFK	Ngritja e perkujdesjes sociale, shendetesore dhe ambulatore - Home Care	20,030.00	222,818.00
<b>Totali: €uro</b>			<b>3,221,863.00</b>	<b>1,686,518.00</b>